# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6125
E hënë, 28 shtator 2020
çmimi 0.40 €


## “Kemi nevojë për të majtën e vërtetë...”

FAQE 11

Shkruan: Bedri ISLAMI



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR “EPOKËN E RE”, FATON KLINAKU



# Aksioni i EULEX-it ishte spektakël për t’i frikësuar njerëzit

Ushtrues i detyrës i kryetarit të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku, e ka vlerësuar të kundërligjshëm aksionin e forcave të EULEX-it për bastisjen e zyrave të kësaj organizate. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, bastisje ka të drejtë të bëjë vetëm Policia e Kosovës. Për këtë arsye, sipas tij, të premten ka mundur të ketë përplasje. Kliniku ka bërë me dije se aksioni i EULEX-it kishte për qëllim frikësimin e njerëzve. Ai ka thënë se OVLUÇK-ja nuk frikësohet prej aksioneve të tilla, duke shtuar se, nëse prapë në zyrat e tyre do të sillen materiale të Speciales, ato do t’i publikojnë FAQE 4-5



## KURTI: QEVERIA NUK E KA SHUMICËN NË KUVEND, SHUMË SHPEJT DO TË KEMI ZGJEDHJE

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se do të ketë shumë shpejt zgjedhje të reja në Kosovë. Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të LV-së, Kurti ka theksuar se kjo qeveri nuk e ka shumicën në Kuvend as për të miratuar ligje të rëndomta e lëre më diçka më tepër. Ai e ka komentuar edhe deklaratën e Isa Mustafës për heqjen e vijave të kuqe për PDK-në. “Ky ishte një gjest qesharak, sepse ne e dimë se këto dy parti ka kohë që funksionojnë në sinkron. Le të bëhen bashkë. Do t’i mundim të dyja”, ka deklaruar Kurti FAQE 8-9

## KATËR MËSIMDHËNËS ME COVID-19, SHKOLLA ‘FAIK KONICA’ KALON NË MËSIM ONLINE FAQE 7




## OPINION

### UÇK-JA ËSHTË MARGARITAR I QYTETËRIMIT EVROPIAN F. 11

Shkruan: Faton ABDULLAHU



## AKTUALE




### TRE TË VDEKUR DHE 47 RASTE TË REJA ME COVID NË KOSOVË F. 7

### PARANDALOHET FUTJA E SUBSTANCAVE NARKOTIKE NË QENDRËN E PARABURGIMIT NË PRIZREN F. 7

## EKONOMI



### SI DO TË FINANCOHEN PROJEKTET INFRASTRUKTURORE QË LIDHIN KOSOVËN DHE SERBINË? F. 8-9

### 1 MILIARD EURO JANË HUMBJET NË SEKTORIN PRIVAT PËR SHKAK TË COVID-19 F. 9

## SPORT

### GJILANI DHE BALLKANI NDAJNË PIKËT, ARBËRIA KRYESON SUPERLIGËN F. 13

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

## Aplikacioni kundër Covid-19 edhe për moshat mbi 16 vjeç




LONDËR, 27 SHTATOR- Personat që jetojnë në Angli dhe Uells së fundmi po nxiten ta shkarkojnë aplikacionin qeveritar për gjurmimin e kontakteve. NHS Covid-19 udhëzon përdoruesit të vetë izolohen për 14 ditë nëse zbulon se ata ishin afër dikujt që ka qenë i infektuar me koronavirus. Ai gjithashtu ka një skaner të check-in për të njoftuar pronarët nëse një vend që ata kanë vizituar zbulohet se është një zonë e nxehtë. Kushdo nga mosha 16 vjeç e lart mund ta shkarkojë aplikacionin në smartphone-in e tij. Sekretari i Shëndetësisë, Matt Hancock, ka pohuar se aplikacioni do të ndihmojë të gjejë sa më shumë persona që janë të infektuar nga Covid-19. "Kushdo që shkarkon aplikacionin do të ndihmojë në mbrojtjen e vetvetes, duke ndihmuar në mbrojtjen e të dashurve të tyre, duke ndihmuar në mbrojtjen e komunitetit të tyre, sepse sa më shumë njerëz që e shkarkojnë atë, aq më efektiv do të jetë", ka thënë ai për "BBC".

# Trump nominon Amy Coney Barrett për gjyqtare në Gjykatën Supreme

UASHINGTON, 27 SHTATOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka nominuar Amy Coney Barrett për gjyqtare në Gjykatën Supreme. Duke folur nga Shtëpia e Bardhë, Trumpi e përshkroi Amy Coney Barrett si "grua me arritje të pashembullt". Nëse konfirmohet nga Senati amerikan, gjyqtarja konservatore Barrett do të zëvendësonte në Gjykatën Supreme gjyqtaren liberale Ruth Bader Ginsburg, që vdiq nga kanceri më 18 shtator.

Nominimi i Barrett vjen pak kohë para mbajtjes së zgjedhjeve presidenciale në ShBA dhe pritet që në Senat të zhvillohet një betejë mes demokratëve dhe republikanëve për emërimin e saj.




Gjyqtarët e Gjykatës Supreme nominohen nga presidenti amerikan, por duhet ta marrin miratimin e Senatit. Presidenti amerikan tha se gjyqtarja Barrett ka "besnikëri të paepur ndaj Kushtetutës".

Nëse gjyqtarja Barrett merr miratimin nga Senati, atëherë në Gjykatën Supreme do të kishte shumicë të gjyqtarëve konservatorë.

Nëse zgjidhet, Barrett, 48-vjeçare, do të bëhej pjesëtarja e tretë e kësaj gjykate që është emëruar nga presidenti republikan, Trump, pasi ai emëroi Neil Gorsuch më 2017 dhe Brett Kavanaugh më 2018.

Gjykata Supreme ka nëntë gjyqtarë të cilët shërbejnë tërë jetën. Ky institucion i drejtësisë merr vendime të rëndësishme për çështje të ndryshme, përfshirë për të drejtat e abortit, kujdesin shëndetësor, ligjet e armëve, lirinë fetare, migracionin dhe lirinë e shprehjes.

# Në Izrael vazhdojnë protestat kundër Netanyahut

JERUSALEM, 27 SHTATOR - Në Izrael vazhdojnë protestat kundër kryeministrit Benjamin Netanyahu pavarësisht karantinës së shpallur për shkak të koronavirusit.

Mijëra protestues në formën e kolonave nga qytete të ndryshme të vendit u mblodhën përpara rezidencës kryeministrore në Kudsin Perëndimor.

Protestuesit shpeshherë brohorisnin me sloganin "Bibi (Netanyahu) kthehu në shtëpi" dhe ftuan kryeministrin të japë dorëheqje për shkak të gjykimit të tij për korrupsion dhe keqmenaxhimin e procesit të Covid-19.

Ndërkohë ka tërhequr vëmendjen se disa protestues mbanin të veshur bluza me



mbishkrimin "Kryeministri i krimit" si dhe hapën pankarta me shkrimet "Të jesh i sëmurë në demokraci është më mirë se të jesh i shëndetshëm në diktaturë".

Policia bllokoi rrugët që dalin në sheshin ku zhvillohet protesta dhe bëri njoftime të shpeshta duke paralajmëruar protestuesit që të kenë kujdes distancën fizike.

Ka rënë në sy se disa protestues kishin marrë me vete shirit për të zbatuar rregullat e distancimit fizik.

Prej më shumë se 4 muajsh në Izrael mbahen protesta për dorëheqjen e Netanyahut për shkak të gjykimit të tij për korrupsion dhe keqmenaxhimin e procesit të Covid-19. Kabineti i kryeministrit izraelit kërkoi të kufizojë protestat me arsyetimin e karantinës por parlamenti e kundërshtoi këtë.

# G7-ta kërkon shtyrjen e pagesës së borxheve për vendet e varfra

NJU JORK, 27 SHTATOR - Ministrat e Financave të G7-s mbështetën njëzëri një shtyrje të pagesës së borxheve si dhe u pajtuan për diskutimin e një lehtësimi të borxhit në të ardhmen për vendet e varfra. Gjatë takimit të fundit u fol edhe për mungesën e transparencës së Kinës në huadhënie. Iniciativa e pezullimit të borxhit, e miratuar në muajin prill nga vendet e G20-s, ka për qëllim t'i ndihmojë vendet në zhvillim që ta tejkalojnë krizën e shkaktuar nga pandemia Covid-19. Deri më tani kjo iniciativë ka ndihmuar 43 shtete të ndryshme të botës për të shtyrë pagesa borxhi në vlerën e 5 miliardë dollarëve.



## Ish-kryeministri italian, sërish pozitiv me Covid



ROMË, 27 SHTATOR- Ish-kryeministri italian Silvio Berluskoni ka rezultuar pozitiv sërish me Covid-19. Berluskoni u shtrua në spital me një fazë të hershme pneumonie dyanëshe pasi rezultoi pozitiv me Covid-19 më 3 shtator. 83-vjeçari iu nënshtrua trajtimit për dhjetë ditë dhe doli nga spitali San Rafaele më 14 shtator. Siç raportohet, Berluskoni ashtu si edhe shumë pacientë të tjerë me Covid po vazhdon të përballet me pasojat e sëmundjes, veçanërisht lodhje, e si pasojë mbetet në krevat. Në të njëjtën kohë, një kthim në spital i tij nuk është i nevojshëm për momentin, sipas medieve në Itali. Berluskoni do t'i nënshtrohet një tjetër testi të hënën, shkruan "Corriere Della Sera".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com




# Tre të vdekur dhe 47 raste të reja me Covid në Kosovë

**Në Kosovë vazhdon të bjerë numri i rasteve të reja me Covid-19. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit janë paraqitur 47 raste të reja me koronavirus, kanë vdekur tre persona dhe janë shëruar 113 të tjerë. Me këtë rast, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se masat e qeverisë kanë ndikuar që në Kosovë të bjerë numri i rasteve me virusin "Korona". "Masat anti-Covid të marra nga Qeveria e Kosovës, pas rekomandimeve të IKShPK-së dhe konsultave me ekspertë të fushës dhe bordit këshillëdhënës, po vazhdojnë të japin rezultate", ka thënë Zemaj**

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se gjatë 24 orëve të fundit kanë vdekur tre persona si pasojë e infektimit me Covid-19 dhe janë shëruar 113 persona. Po ky institut ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 47 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 525 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 47 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 3 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast nga Klinika Infektive, 1 rast nga spitali Ferizaj dhe 1 rast nga Mjekimi Intensiv Qendror, QKUK). Numri total i rasteve pozitive është 15 472 raste nga 65 979 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2 dhe 622 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 113 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 13 278 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 572", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve të reja me Covid sipas komunave të Kosovës. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 17 raste, komuna Gjilan 9 raste, komuna Istog 5 raste, komuna Kamenicë 4 raste, komuna Fushë Kosovë 3 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast komunat Ferizaj, Lipjan, Obiliq, Pejë, Podujevë, Suharekë dhe Vushtrri. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!", ka njoftuar IKShPK-ja.

### Rënia e rasteve me Covid, Zemaj: Masat e qeverisë po japin rezultate

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka komentuar gjendjen momentale me Covid-19 në Kosovë. Zemaj ka thënë se masat anti-Covid të ndërmarra nga qeveria Hoti janë duke dhënë rezultate në luftën kundër pandemisë. "Masat anti-Covid të marra nga Qeveria e Kosovës pas rekomandimeve të IKShPK-së dhe konsultave me ekspertë të fushës dhe bordit këshillëdhënës po vazhdojnë të japin rezultate. Edhe sot, nga 525 testime sa janë bërë brenda 24 orëve, 47 kanë rezultuar pozitiv me Covid-19", ka thënë Zemaj, duke kërkuar nga qytetarët që të kenë kujdes dhe t'i respektojnë masat kundër Covidit. "Këto rezultate dhe kjo situatë e menaxhueshme assesi nuk duhet të kthehet në pakujdesi. Të gjithë së bashku jemi partnerë në proces, të gjithë aktorët duhet të marrin dhe t'i kryejnë përgjegjësitë që i ngarkon ligji në mënyrë që virusit mos t'i japim këmbë, por ta minimizojmë praninë e tij. Shëndeti është edhe mision për ta ruajtur shëndetin individual dhe nga ai individual edhe atë kolektiv duhet të jetë mision i të gjithëve, andaj secili ta japim maksimumin për ta luftuar virusin", është shprehur Zemaj. Ai ka thënë se institucionet e Kosovës janë të motivuara për ta fituar betejën kundër virusit "Korona". "Tashmë kur edhe shtetet evropiane kanë filluar ta largojnë Kosovën nga lista e zezë sa i përket pranisë së Covidit, ne kemi motiv shtesë për të qenë bashkë për ta fituar betejën. Koordinimet e mëtejme, me faktorët relevantë, vijojnë sot, nesër, me baza të rregullta", ka deklaruar Zemaj.

# Kosova fiton pesë Mirënjohje Nderi në Olimpiadën Matematika Ndërkombëtare

PRISHTINË, 27 SHTATOR (ER) - Ka përfunduar me sukses Olimpiada e 61-të Matematike Ndërkombëtare, e organizuar në formatin online. Ekipi i Kosovës ka arritur rezultate solide dhe ka fituar pesë Mirënjohje Nderi. Mirënjohje Nderi kanë fituar nxënësit: Dren Neziri (8 pikë), Lorik Ramosaj (8 pikë), Bardh Osmani (8 pikë), Andi Sejdiu (7 pikë) dhe Florian Shabani (7 pikë).

Shoqata e Matematikanëve e Kosovës ka përgëzuar ekipin e Kosovës për përfaqësim të denjë të shtetit të Kosovës në këtë olimpiadë prestigjioze. "Shoqata e Matematikanëve e Kosovës mbetet e përkushtuar të kontribuojë me të gjitha mundësitë dhe kapacitetet që ka në dispozicion për t'i mbështetur të rinjtë e talentuar në fushën e matematikës", theksohet në njoftimin e Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës.





FLET PËR "EPOKËN E RE", FATON KLINAKU

# AKSIONI I EULEX-it ISHTE SPEKTAKËL PËR T'I FRIKËSUAR NJERËZIT

Ushtrues i detyrës i kryetarit të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku, e ka vlerësuar të kundërligjshëm aksionin e forcave të EULEX-it për bastisjen e zyrave të kësaj organizate. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës bastisje ka të drejtë të bëjë vetëm Policia e Kosovës. Për këtë arsye, sipas tij, të premten ka mundur të ketë përplasje.
Kliniku ka bërë me dije se aksioni i EULEX-it kishte për qëllim frikësimin e njerëzve. Ai ka thënë se OVLUÇK-ja nuk frikësohet prej aksioneve të tilla, duke shtuar se nëse prapë në zyrat e tyre do të sillen materiale të Speciales, ato do të publikohen

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Ushtruesi i detyrës i kryetarit të Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), Faton Klinaku, ka kritikuar ashpër aksionin e forcave të EULEX-it për bastisjen e zyrave të kësaj organizate. Ai ka vlerësuar se aksioni i forcave speciale të EULEX-it ka qenë i kundërligjshëm.

Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Klinaku ka thënë se në bazë të Kodit Penal të Republikës së Kosovës bastisje ka të drejtë të bëjë vetëm Policia e Kosovës. "Aksioni i EULEX-it ka qenë i kundërligjshëm sepse Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh që bastisjet dhe arrestimet mund t'i bëjë vetëm Policia e Kosovës. Pra, ka qenë aksion i kundërligjshëm. Për këtë arsye atë ditë ka qenë situatë e tensionuar dhe vetëm disa shokë tonë të kryesisë së organizatës e kanë qetësuar situatën, sepse ka mundur të ketë edhe përplasje", ka thënë Klinaku. Ai ka bërë me dije se aksioni i forcave speciale të EULEX-it kishte për qëllim fiksimin e njerëzve.

Klinaku ka thënë se OVLUÇK-ja do ta vazhdojë punën e saj dhe nuk do t'iu frikësohet aksioneve të tilla. "Qëllimi i tyre ishte të bëjnë spektakël dhe t'i frikësojnë njerëzit. Por ne e themi hapur, se pavarësisht se Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë në burg, organizata jonë i ka Kuvendin dhe Kryesinë, e cila më ka caktuar mua për ta udhëhequr organizatën. Ne nuk do të ndalemi së punuari për punët që i kemi para vetes", ka deklaruar Klinaku.

Ai ka paralajmëruar se nëse dikush në zyrat e tyre do të sjellë përsëri materiale të Speciales, OVLUCK-ja do t'i publikojë ato. "Personi që i ka sjellë dosjet e fundit ka thënë se



do të sjellë CD. Natyrisht se çdo gjë që do të sjellë dikush, ne do t'i publikojmë para mediave. Nuk e kemi ndërmend të frikësohemi dhe të ndalemi në këtë punë, sepse kemi thënë se ne nuk do t'i mbajmë fshehtë skandalet e tyre", është shprehur Klinaku.

Ai ka kritikuar qëndrimin e institucioneve shtetërore ndaj këtij aksioni të EULEX-it, ndërsa kryeministrin Avdullah Hoti e ka quajtur mjeran të politikës. "Z. Thaçi dhe as politikanët e tjerë nuk kanë nevojë të flasin fare. Ata duhet të veprojnë, sepse Gjykatës Speciale i ka skaduar mandati më 2 gusht dhe ata duhet të ndërmarrin masa ndaj saj. Ose ta shfuqizojnë apo t'ia vazhdojnë mandatin ose ta amandamentojmë ligjin qysh kemi kërkuar ne si organizatë, që kjo gjykatë t'i hetojë edhe krimet serbe që janë bërë në Kosovë", ka thënë Klinaku.

**"Epoka e re":** *Z. Klinaku, si e keni parë aksionin e EULEX-it për t'i bastisur zyrat e OVLUÇK-së dhe arrestimin e udhëheqësve të kësaj organizate?*

**Klinaku:** Aksioni i EULEX-it ka qenë i kundërligjshëm, sepse Kodi Penal i Republikës së Kosovës parasheh që bastisjet dhe arrestimet mund t'i bëjë vetëm Policia e Kosovës. Pra, ka qenë aksion i kundërligjshëm. Për këtë arsye atë ditë ka qenë situatë e tensionuar dhe vetëm disa shokë tonë të kryesisë së organizatës e kanë qetësuar situatën, sepse ka mundur të ketë edhe përplasje.

**"Epoka e re":** *Meqenëse e konsideroni aksionin të kundërligjshëm, do të ankoheni në ndonjë instancë të drejtësisë?*

**Klinaku:** Kujt t'i ankohemi? Ju e dini qëndrimin tonë. Ne nuk e njohim Gjykatën Speciale dhe nuk merremi fare me procedurat e tyre. Ndërsa për këtë çështje dihet se ne si veteranë kemi kërkuar me shkrim nga Kuvendi i Kosovës se si duhet të bëhet amandamentimi i Ligjit për Specialen. Institucionet duhet të veprojnë në këtë drejtim. Me pas shtet ashtu si duhet nuk është dashur të ndodhin këto gjëra, sepse vetëm Policia e Kosovës ka kompetencë për këso raste dhe askush tjetër.

**"Epoka e re":** *A keni kontaktuar me z. Gucati dhe z. Haradinaj pas arrestimit?*

**Klinaku:** Nuk kemi mundur të kontaktojmë sepse atyre nuk ua lejojnë telefonat. Vetëm nganjëherë ua japin telefonin që të flasin me familjarët. Për z. Gucati e di se ka folur me familjen, ndërsa për z. Haradinaj nuk e di nëse ka mundur të flasë me familje.

**"Epoka e re":** *Pas aksionit, Gjykata Speciale ka treguar se kishte fletarrestime për z. Gucati dhe z. Haradinaj. Dyshimet janë se arrestimet kanë të bëjnë me publikimin e dosjeve nga zyrat e OVLUÇK-së gjatë këtij muaji. Cili është vlerësimi juaj për këto pretendime?*

**Klinaku:** Hetimet është dashur t'i bëjë vetë gjykata. Aty ku ka ndodhur skandali, pra aty ku kanë rrjedhur dosjet. Kështu që, nuk ka pasur nevojë të vijnë fare te ne.

**"Epoka e re":** *Pse mendoni se ka ndodhur ky aksion kur dihet që OVLUÇK-ja çdoherë është treguar e gatshme të bashkëpunojë në lidhje me dosjet e publikuara?*

**Klinaku:** Qëllimi i tyre ishte të bëjnë spektakël dhe t'i frikësojnë njerëzit. Por ne e themi hapur se, pavarësisht se Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj janë në burg, organizata jonë i ka Kuvendin dhe Kryesinë, e cila më ka caktuar mua për ta udhëhequr organizatën. Ne nuk do të ndalemi së punuari për punët që i kemi para vetes.

**"Epoka e re":** *Cili do të jetë reagimi i OVLUÇK-së pas këtyre arrestimeve? Do të organizoni ndonjë protestë?*

**Klinaku:** Ne të hënën fillojmë punën. Do të takohemi me strukturat tona drejtuese të organizatës dhe pastaj do të njoftoheni me kohë për veprimet që do t'i marrim.

**"Epoka e re":** *Nëse përsëri në zyrat e juaja sillen dosje, do t'i publikoni?*

**Klinaku:** Personi që i ka sjellë dosjet e fundit ka thënë se do të sjellë CD. Natyrisht se çdo gjë që do të sjellë dikush ne do t'i publikojmë para mediave. Nuk e kemi ndërmend të frikësohemi dhe të ndalemi në këtë punë, sepse kemi thënë se ne nuk do t'i mbajmë fshehtë skandalet e tyre.

**"Epoka e re":** *Deri më tani kemi parë disa reagime të institucioneve, ku presidenti dhe disa përfaqësues politikë e kanë kritikuar aksionin e EUELX-it duke e vlerësuar të panevojshëm. Ka qenë i duhur ky reagim?*

**Klinaku:** Z. Thaçi dhe as politikanët e tjerë nuk kanë nevojë të flasin fare. Ata duhet të veprojnë, sepse Gjykatës Speciale i ka skaduar mandati më 2 gusht dhe ata duhet të ndërmarrin masa ndaj saj. Ose ta shfuqizojnë apo t'ia vazhdojnë mandatin ose ta amendamentojmë ligjin qysh kemi kërkuar ne si organizatë, që kjo gjykatë t'i hetojë edhe krimet serbe që janë bërë në Kosovë. Nuk ka nevojë që të bëhen ato reagime sa për sy e faqe. Ata duhet të veprojnë, sepse aksioni i së premtes ka qenë i kundërligjshëm.

**"Epoka e re":** *Ndërsa kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se për qeverinë veprimet e Dhomave të Specializuara burojnë nga detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre ligjore dhe kushtetuese?*

**Klinaku:** Ai është një mjeran i politikës. Një ditë para se ta japë qëndrimin e tij, ai është takuar me Quintin dhe aty i ka marrë direktivat se çka me fol. Me qenë si duhet shteti, Ministria e Drejtësisë është dashur të merret me këtë çështje, pra me atë çfarë ka ndodhur atë ditë, me ato veprime të kundërligjshme.

# DEIMEL: RRJEDHJA E DOKUMENTEVE MINON PUNËN E GJYKATËS NË HAGË

**Prishtinë, 27 shtator-** Rrjedhja e dokumenteve të Dhomës së Specializuar dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Hagë, që ndryshe njihen edhe si Gjykata Speciale, është një skandal i madh dhe shumë i rrezikshëm për dëshmitarët, thotë në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë", Johanna Deimel, anëtare e bordit të Shoqatës për Evropën Juglindore (Southeast Europe Association) në Mynih. Ajo thotë se zhvillimet e fundit e minojnë punën e Gjykatës. "Ky është padyshim një sulm mbi sigurinë. Është një skandal i madh dhe shumë i rrezikshëm për dëshmitarët. Brenda dy muajsh, për të tretën herë me rradhë, ka pasur rrjedhje të dokumenteve konfidenciale të gjykatës. Kjo e minon punën e Gjykatës (Speciale) dhe siç e thashë të dëshmitarëve të cilët tashmë janë pjesë e saj dhe ata që janë të gatshëm të bashkëpunojnë. Unë jam shumë e gëzuar që vendet e Kuint-it (Franca, Gjermania, Italia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara) ishin shumë të qarta duke e dënuar çdo përpjekje për të minuar dhe zhvlerësuar misionin e Gjykatës Speciale. Dhe, mbase për shkak të rrjedhjes së këtyre dokumente kemi edhe arrestimin e parë nga ana e gjykatës", ka thënë ajo.



Deimel ka theksuar se ka qenë njëra prej kritikueseve të kësaj gjykate. "Unë kam qenë njëra prej kritikueseve të kësaj gjykate për faktin se kishte kaluar shumë kohë dhe asgjë nuk po ndodhte. Por, në anën tjetër unë kam pasur besim se do të jetë një proces i kujdesshëm dhe kërkon kohë në identifikimin e dëshmitarëve për të shqyrtuar dokumentet dhe për të zhvilluar intervistimin. Tash, pasi kemi aktakuzën e parë të ngritur, do të shohim në muajt e ardhshëm se çfarë do të ndodhë", ka deklaruar Deimel.

Lidhur me marrëveshjen për normalizim ekonomik, të arritur në Uashington mes Kosovës dhe Serbisë, analistja e pavarur Diemel, vlerëson se e gjithë ajo "shfaqje" mund të ketë një lojë tjetër në prapaskenë. "Nëse flas për marrëveshjen e Uashingtonit mund t'ju them se jam në mëdyshje. Jam në mëdyshje nga kjo shfaqje në Uashington; nga nominimi për çmimin Nobel; nga medaljet; nga Liqeni Trump pastaj nga këndimet për Virxhinian Perëndimore në Beograd. Të gjitha këto çojnë në karakteristika të një realiteti satirik. Unë jam konfuze edhe nga videoja që kemi parë nga Zyra Ovale në fillim të shtatorit, dhe po e pyesja veten, se çfarë në të vërtetë ka pasur mbrapa gjithë këtyre 'qirinjve të tymit' dhe thirrjeve bombastike 'Amerika është e mrekullueshme', të cilat i kemi dëgjuar këto ditë edhe nga Prishtina dhe Beogradi. Pra, e pyesja veten se si e lejuan veten presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq dhe kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti të bien në atë situatë aq të padinjitetshme dhe nënshtruese. Vërtet ia bëra vetes këto pyetje", është shprehur Deimel.

Mbahet mbledhja e 41-të e Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje

# Kurti: Qeveria nuk e ka shumicën në Kuvend, shumë shpejt do të kemi zgjedhje

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se do të ketë shumë shpejt zgjedhje të reja në Kosovë. Në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të LV-së, Kurti ka theksuar se kjo qeveri nuk e ka shumicën në Kuvend as për të miratuar ligje të rëndomta e lëre më diçka më tepër. Ai ka komentuar edhe deklaratën e Isa Mustafës për heqjen e vijave të kuqe për PDK-në. “Ky ishte një gjest qesharak, sepse ne e dimë se këto dy parti ka kohë që funksionojnë në sinkron. Le të bëhen bashkë. Do t’i mundim të dyja”, ka deklaruar Kurti



EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 27 shtator** - Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur të dielën mbledhjen e dyzetë e një të Këshillit të Përgjithshëm. Në këtë mbledhje është diskutuar për situatën politike në vend dhe për zgjedhjet e brendshme që do të mbahen në këtë subjekt politik.

Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se qendrat e partisë që drejton i kanë bërë planifikimet dhe përgatitjet e duhura. “Nga 20 shtatori kemi nisur zgjedhjet në disa pika dhe, deri më sot, pra të dielën e 27 shtatorit, është paraparë që të mbahen zgjedhje në 12 pika, e gjatë javës së ardhshme edhe në shtatë të tjera. Në muajin tetor planifikohen të mbahen zgjedhjet në 192 pika, në nëntor në 152 pika, e në dhjetor në 66 pika, me ç’rast në total deri në fund të vitit 436 pika, duke mos i llogaritur ato në mërgatë. Zgjedhjet vazhdojnë në janar dhe shkurt të vitit të ardhshëm”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka shtuar se sfidat pritet të jenë me pikat me anëtarësi më të madhe. “Kjo periudhë është ndër periudhat më të rëndësishme të organizatës sonë, me reforma të mëdha organizative, që do të rezultojnë edhe me organizatën e gruas dhe atë të rinisë në Lëvizjen Vetëvendosje. Në përgjithësi, për një subjekt politik, zgjedhjet e brendshme janë edhe festa më e madhe dhe sfida më e rëndësishme. Me këtë rast më duhet përmendur anëtarësimin tonë në Aleancën Progresive, që ka qenë një nismë e mëhershme e jona nga viti 2015”, ka thënë Kurti.

Ai në këtë mbledhje ka folur edhe për marrëveshjen e arritur në Uashington në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kurti këtë marrëveshje e ka quajtur të rrezikshme. “Avdullah Koti po shpejton të nënshkruajë gjithçka, të hapë çdo temë, duke e degraduar pozitën ndërkombëtare të Kosovës dhe statusin e vendit tonë, si shtet i pavarur e sovran. Është hera e parë që një qeveri e Kosovës merr anë në zgjedhjet amerikane dhe rreshtohet 100 për qind pas njërit kandidat dhe kundër tjetrit. Athua se e dinë paraprakisht se kush do të fitojë në zgjedhjet në Amerikë?! Jo vetëm që rreshtohen në fushatë pas Trumpit, por pranojnë t’i nënshkruajnë koncesionet më të mëdha që i janë bërë Serbisë prej Kosovës, qysh prej pas luftës. Në marrëveshjen e 4 shtatorit, e cila u prit fort mirë prej opinionit dhe politikës në Serbi, ‘qeveria Koti’ nënshkroi për rikthimin e Serbisë si palë në politikat energjetike të Kosovës, ku ne vetëm pak muaj më parë, gjatë qeverisjes sonë, kishim arritur pavarësimin elektro-energjetik të Kosovës prej Serbisë me votimin e favorshëm në ENTSO-E”, ka deklaruar Kurti. Sipas Kurtit, në marrëveshjen e 4 shtatorit u nënshkrua që Serbisë t’i hapet dera për pretendime territoriale në Kosovë, duke e njohur atë si palë sa i përket konsiderimit ekonomik të Liqenit të Ujmanit. “Liqeni i Ujmanit është tërësisht në pronësi të Kosovës, toka mbi të cilën është vendosur ai ujë, është pronë e Kosovës, edhe nëse është në Serbi. Fakti që Serbia njihet si palë për administrimin e pronave të Kosovës është një prapakthim i madh, i cili vjen prej një qeverie pa legjitimitet dhe pa pikë patriotizmi”, është shprehur Kurti.

Gjithashtu, Kurti ka thënë se në po atë marrëveshje Serbia fitoi edhe të drejtën për ta realizuar mini-shengenin. “Minishengenin e kishin kundërshtuar të gjithë politikanët e Kosovës. Po të ishte çështje e tregtisë së lirë, nuk ka nevojë për mini-schengen, sepse tashmë vendet e rajonit e kanë CEFTA-n”, ka thënë ai.

Kurti ka folur edhe për njohjen nga Izraeli. “Na thonë se Kosova doli e fituar meqë e mori njohjen e Izraelit. Duke shpresuar që kjo njohje e rëndësishme të konkretizohet sa më shpejt, sepse ende nuk është konkretizuar, shtrohet pyetja, ç’lidhje ka njohja e Kosovës nga Izraeli, me lëshimet që ia bëri Kosova Serbisë? A duan këta të na thonë që tash e tutje, për secilën njohje ndërkombëtare që merr Kosova, duhet t’i bëjmë lëshime Serbisë, t’i japim diçka asaj?”, ka deklaruar lideri i LV-së.

Ai ka thënë se Hoti është duke bërë lëshime edhe në procesin e dialogut që po zhvillohet në Bruksel. “Kryeministri Koti është vërsulur që të bëjë lëshime edhe në Bruksel. Atje ka pranuar të diskutojë për rikthimin e Zajednicës, idesë që u vra prej protestave popullore e u varros prej Gjykatës Kushtetuese. Avdullah Koti po e ngjall prej vdekjes ‘Zajednicën’, e po e kthen si zombi, a si lugat, për ta bllokuar përfundimisht Kosovën me një Republikë Serbe brenda saj”, ka thënë Kurti, i cili ka folur edhe për zhvillimet e fundit sa i përket Gjykatës Speciale. “Dikujt këto mund t’i duken si zhvillime të fundit, mirëpo nuk janë zhvillime aq të reja. Pesë vjet më parë ne i kemi parashikuar këto veprime të rrezikshme dhe e kemi kundërshtuar me sa mundësi që kemi pasur, krijimin e kësaj gjykate. Mirëpo presidenti i tanishëm në atë kohë thoshte se ata që janë kundër Gjykatës janë tradhtarë. Sepse ai ka shpresuar që Gjykata i merr luftëtarët e tjerë, por jo atë. Dhe mendjen e ka pasur se si të bëhet president për vete e jo çka do të ndodhë me UÇK-në”, ka theksuar Kurti.

Ai ka thënë se zgjidhja e të gjitha këtyre problemeve janë zgjedhjet e reja. “Dhe zgjedhje do të ketë shumë shpejt sepse kjo qeveri nuk e ka shumicën në Kuvend as për të miratuar ligje të rëndomta e lëre më diçka më tepër. Siç e pamë së fundmi, LDK-ja i hoqi vijat e kuqe ndaj PDK-së. Ky ishte një gjest qesharak sepse ne e dimë se këto dy parti ka kohë që funksionojnë në sinkron. Le të bëhen bashkë. Do t’i mundim të dyja, sepse është koha e Vetëvendosje!-s, është koha që të qeverisim me ekspertizë, me ndershmëri e me patriotizëm dhe ta shpëtojmë Kosovën”, ka thënë Kurti.

# Katër mësimdhënës me Covid-19, shkolla "Faik Konica" kalon në mësim online

Nxënësit në Shkollën Fillore "Faik Konica" në Prishtinë do ta vazhdojnë mësimin në distancë, apo në formën online, pasi katër mësimdhënës të këtij institucioni arsimor kanë rezultuar pozitivë me Covid-19




EPOKA E RE Qendresa RAMA

**Prishtinë, 27 shtator** - Katër mësimdhënës në Shkollën Fillore "Faik Konica" kanë dalë pozitivë me Covid-19. Lajmin e ka bërë me dije të dielën ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj. Zemaj ka thënë se me gjithë përgatitjet në bazë të rekomandimeve, situata ka ndryshuar në shkollën "Faik Konica" në Prishtinë. Tashmë, sipas tij, mësimi në shkollën "Faik Konica", nga skenari 'A', do të kalojë në skenarin 'C', mësimin online për dy javë. "Nga hulumtimi dhe mbikëqyrja e situatës epidemiologjike, IKShPK-ja ka bërë testimin e të gjithë arsimtarëve, katër prej të cilëve rezultuan pozitivë me Covid-19. Prandaj, IKShPK-ja ka rekomanduar që mësimi në shkollën 'Faik Konica', nga skenari 'A', të kalojë në skenarin 'C', mësimin online, për dy javë", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka pohuar se IKShPK-ja dhe Drejtoria Komunale e Arsimit në Prishtinë do ta monitorojnë gjendjen në vazhdimësi, ndërsa Task Forca komunale bashkë me Institutin do ta bëjnë vlerësimin e gatishmërisë së shkollës për të rifilluar mësimin në skenarin "A".

Ministri Zemaj ka theksuar se nga dita e parë e fillimit të vitit të ri shkollor ka bërë thirrje për kujdes të shtuar, respektim të masave anti covid, por edhe vigjilencë në shkolla. "Të nderuar nxënës, mësimdhënës, prindër, kërkoj t'i respektoni masat anti covid, të jemi bashkëpunues dhe të gjithë së bashku të punojmë për të mirën e fëmijëve tanë, të mos përsëriten rastet e tilla", ka shkruar Zemaj.

Më herët gjatë këtij muaji, në Shkollën Fillore "Mustafë Venhari" në Komunën e Vushtrrisë tetë nxënës nën moshën dhjetëvjeçare dhe tetë mësimdhënës rezultuan pozitivë me Covid-19. Pas kësaj, institucionet rekomanduan që mësimi në këtë shkollë të kalojë në mësim në distancë.

Ministria e Arsimit ka paraparë që në këtë vit shkollor mësimi të realizohet përmes tre skenarëve. Skenari A ka të bëjë me zhvillimin e mësimit në ambientet shkollore, skenari B apo mësimi i kombinuar përfshin rikthimin e pjesshëm të nxënësve në shkolla (prani të nxënësve në shkolla, e kombinuar edhe me mësimin në distancë) dhe skenari C është mësimi në distancë.

Viti i ri shkollor në institucionet para-universitare në Kosovë ka filluar më 14 shtator, me prani fizike të nxënësve në shkolla, por duke respektuar rekomandimet për mbrojtjen nga pandemia e koronavirusit: mbajtjen e maskës, distancës dhe higjienën personale.

# Parandalohet futja e substancave narkotike në Qendrën e Paraburgimit në Prizren



**Prishtinë, 27 shtator (ER)** - Të dielën rreth orës 08:20 në Qendrën e Paraburgimit në Prizren oficerët korrektues kanë arritur ta parandalojnë futjen e substancave narkotike në këtë qendër paraburgimi. Fillimisht oficerët korrektues kanë vërejtur disa lëvizje të dyshimta të të burgosurve në shëtitoren e Qendrës së Paraburgimit në Prizren dhe menjëherë kanë filluar bastisjen brenda dhomave të qendrës, me ç'rast bastisja ka rezultuar pozitive, ku gjatë bastisjes në njërën nga dhomat është gjetur një shishe e plastikes e madhësisë O. 5l, e shpuar, e cila dyshohet se mund të është përdorë për konsumim të substancave narkotike. "Gjatë bastisjes ka rrjedhur informacioni se substanca narkotike po hedhet nga rruga dhe mbase mund të ketë mbetur në kulm. Menjëherë është bërë bastisja e kulmit dhe si rezultat i saj në kulmin e Qendrës së Paraburgimit në Prizren është gjetur një pako cigareje ku në brendinë e saj kishte substancë narkotike. Lidhur me këtë rast, oficerët korrektues kanë lokalizuar substancën e dyshuar narkotike dhe menjëherë kanë njoftuar Njësitin Antidrogë të Policisë së Kosovës", është bërë me dije në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, i paraburgosuri, i dyshuar se substanca e kapur në kulm ka qenë e dedikuar për të, është ndarë nga të tjerët dhe është vendosur në dhomën C5, me ç'rast ndaj tij dhe të paraburgosurve të të njëjtës dhomë është iniciuar procedura disiplinore. Me qëllim të eliminimit të dukurive negative nëpër institucionet korrektuese dhe ato të paraburgimit, Shërbimi Korrektues i Kosovës do të vazhdojë ta ketë primare luftimin e dukurive negative dhe kontrabandës.

# Haskuka, Osmani, ministra e deputetë marrin pjesë në ecjen 'Garë për shërim'

**Prizren, 27 shtator (ER)** - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me kryetaren e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ministra e deputetë, drejtorë e zyrtarë komunalë, kanë marrë pjesë në ecjen "Race for the Cure (garë për shërim)", e cila është organizuar nga Shoqata "Renesansa", në përkrahje të të mbijetuarave dhe atyre që po e luftojnë kancerin e gjirit. "Fakti se numri i të prekurve nga kanceri i gjirit po rritet për çdo vit është mjaft shqetësues dhe, për fat të keq, me shqetësime të tilla po përballet edhe vendi ynë", ka thënë Haskuka.

Ai ka treguar se si Komunë e Prizrenit gjatë tri viteve të fundit janë munduar maksimalisht të kontribuojnë në zbulimin e hershëm të kancerit, duke ofruar këto shërbime në shëndetësinë primare: 2 586 shërbime të analizave për tumor markerë - vetëm për gjashtë muaj të këtij viti; 2 692 ekzaminime të ultrazërit të gjirit gjatë periudhës 2018-2020; 1 734 ekzaminime të mamografisë gjatë periudhës 2018-2020, si dhe mbështetje financiare në vlerë prej 217 200 eurosh për 724 persona të sëmurë nga kanceri, përfshirë këtu edhe ato të kancerit të gjirit.





Video Grab (RFE/RL)

# Si do të financohen projektet infrastrukturore që lidhin Kosovën dhe Serbinë?

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Afër 400 milionë euro do t'i duhen Kosovës për t'i realizuar dy nga projektet infrastrukturore që bëjnë lidhjen mes Prishtinës dhe Beogradit. Autostrada e Paqes 'Prishtinë - Merdar', si dhe linja hekurudhore e relacionit po të njëjtë, janë dy projektet për të cilat në marrëveshjen e nënshkruar më 4 shtator në Uashington në mes të Kosovës dhe Serbisë, Kosova është zotuar se do t'i përmbushë. Financimi i këtyre dy projekteve është thënë se do të bëhet nga Korporata Financiare për Zhvillim e ShBA-së (DFC) dhe EXIM (Export-Import) Banka, por që zyrtarë të institucioneve të Kosovës nuk kanë dhënë detaje për mënyrën e financimit të tyre përmes granteve, kredive apo mënyrave të tjera.

Këtë javë Kosovën dhe Serbinë i vizitoi një delegacion amerikan, në krye me Adam Boehler, kryeshefin e DFC-së. Temë e bisedimeve me zyrtarë në Kosovë dhe Serbi ishte zbatimi i marrëveshjes së arritur në Shtëpinë e Bardhë më 4 shtator.

## Kredi apo grante?

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) do ta ndihmojë Qeverinë e Kosovës për t'i zbatuar projektet e marrëveshjes si dhe do të ofrojë mbështetje për zbatimin e projekteve të infrastrukturës, energjisë dhe krijimit të vendeve të punës.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, tha për "Radion Evropa e Lirë" se në takimet që kanë pasur në Serbi me delegacionin nga Uashingtoni, modalitetet e financimit të projekteve që dalin nga marrëveshja e Uashingtonit janë diskutuar, por nuk është se janë sqaruar. Ai thotë se është duke u folur për disa mundësi të cilat, siç thotë ai, janë shumë të favorshme për financimin e këtyre projekteve. "Sigurisht se do të jenë në formë të kombinuar, prej kredive afatgjata me norma të favorshme të interesit dhe në disa raste ka mundësi edhe për grante për shpenzime të ndryshme operative që mund të jenë në projekte të caktuara. Ka disa modalitete që i ka Korporata Financiare Amerikane dhe EXIM Banka, që është bankë amerikane, e që e financon eksportin e kompanive amerikane dhe e cila i ka përmendur edhe disa opsione të granteve për shpenzime operative të kompanive që mund të përfitojnë nga këto", thotë ai.

## Kush janë financuesit e projekteve infrastrukturore?

Korporata Ndërkombëtare për Zhvillim Financiar e ShBA-së (DFC) është bankë e zhvillimit të Amerikës e cila bashkëpunon me sektorin privat duke financuar zgjidhjet e sfidave më kritike me të cilat përballet bota në zhvillim. DFC investon në sektorë duke përfshirë energjinë, kujdesin shëndetësor, infrastrukturën kritike dhe teknologjinë. DFC, po ashtu, siguron financim për bizneset e vogla dhe gratë sipërmarrëse, me qëllim krijimin e vendeve të punës në tregjet në zhvillim.

Ndërkaq, Banka EXIM u ofron bizneseve amerikane zgjidhje për t'u mbrojtur nga mospagimi i blerësve të huaj dhe i mbështet ato në eksportin e mallrave dhe shërbimeve amerikane.

Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, në një intervistë dhënë për "Rel" ka thënë se ende nuk dihet se kush do t'i financojë projektet që dalin nga marrëveshja, por ka shtuar se DFC-ja është duke parë mundësitë për ta pasur një prani të madhe në rajon, duke përfshirë edhe Kosovën, si dhe do të jetë e përfshirë "Banka jonë EXIM, Banka Eksport-Import". "Ne shpresojmë se do të ketë investime edhe nga sektori privat. Dhe sigurisht investimet evropiane... Unë mendoj se kjo do të jetë një çështje për bisedime intensive në muajt e ardhshëm, por asgjë nuk është vendosur ende", ka deklaruar ambasadori Kosnett.

Ish-ministri i Ekonomisë dhe Financave, Haki Shatri, në një bisedë për "Rel" thotë se duke parë se kush do t'i financojë këto projekte infrastrukturore, nënkuptohet që këto financime do të jenë kredi. "Çdo marrëveshje që lidhet me financim të infrastrukturës është e mirëseardhur. Financimi do të jetë me kredi, për të cilat nuk e dimë se çfarë kredi janë në çfarë kushte po jepen, sa është afati i kthimit dhe norma e interesit. Sidoqoftë, janë kredi që jepen për investime në infrastrukturë, që është jetësore për ekonomi dhe integrim", thotë ai.

## Krijimi i vendeve pune

Investimi në këto projekte infrastrukturore, thotë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, do të krijojë një infrastrukturë strategjike, e cila më pas do të tërheqë një numër të madh të kompanive ndërkombëtare, ku edhe mundësia për krijimin e vendeve të reja të punës rritet. "Ka një orientim që kompanitë amerikane që janë në Azi të vendosen në këtë pjesë dhe infrastruktura e modernizuar e ndihmon këtë. Kosova mund të shndërrohet në një epiqendër të logjistikës dhe transportit ndërkombëtar. Ndoshta ky efekt nuk shihet menjëherë, por në një periudhë afatmesme do të kthehet në shumë efekte pozitive", thotë ai.

## 27 kilometra autostradë, 240 milionë euro

E ashtuquajtur në marrëveshje Autostrada e Paqes, kjo autostradë, në territorin e Kosovës, është vazhdimësi në autostradën 'Ibrahim Rugova', që ka përfunduar deri në Besi, fshat ky që gjendet rreth magjistrales Prishtinë - Podujevë. Mbesin edhe rreth 24 kilometra tjera deri në Merdare.

Ministri i Infrastrukturës në Qeverinë e Kosovës, Arban Abrashi ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se këto kilometra të mbetura kanë një kosto prej përafërsisht 240 milionë euro.

## BE-ja: Autostrada e Paqes është një lidhje me prioritet

Bashkimi Evropian ndërkohë ka thënë për "Rel" se shumë prej projekteve të përfshira në marrëveshjen e Uashingtonit për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë, janë duke u zhvilluar në kuadër të Kornizës së Investimeve

në Ballkanin Perëndimor.
Projekti për autostradën që lidh Kosovën me Serbinë është një projekt i nisur me herët dhe si i tillë ishte përkrahur edhe nga Bashkimi Evropian.
Ky projekt është i përfshirë edhe në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor të Bashkimit Evropian. Në këtë kornizë ky projekt figuron se është në përgatitje. "Rreth 223 milionë euro përfshijnë 5 milionë donacione nga Bashkimi Evropian në asistencë teknike për pjesën Prishtinë - Merdar dhe 230 milionë për pjesën në mes të Nishit dhe Ploçnikut, duke përfshirë 50 milionë euro donacionet për asistencë teknike dhe punime. Derisa Autostrada e Paqes është një lidhje me prioritet, ne presim edhe investime të tjera nga BE-ja", thotë në një përgjigje për "Rel", Ana Pisonero, zëdhënëse e BE-së për Partneritete Ndërkombëtare, Fqinjësi dhe Zgjerim.
Ndërkaq në rastin e hekurudhave, BE-ja ka aprovuar 1.4 milion euro donacione për studimit e para-fizibilitetit për sektorë të ndryshëm. "Disa nga projektet e nënvizuara në Uashington janë të reja dhe duhet të vlerësohen në pjesën e fizibilitetit dhe përputhshmërisë, ashtu sikurse BE-ja planifikon për rajonin. Ne jemi të gatshëm të punojmë me partnerët tanë nga SHBA-ja dhe po shikojmë nga e ardhmja për detaje të tjera rreth kontributit të tyre financiar", thuhet në përgjigje.
Bashkimi Evropian ndërmjetëson dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë qysh nga vitin 2011.



### 45 kilometra hekurudhë, 150 milionë euro

Përveç autostradës, në marrëveshjen e nënshkruar në Shtëpinë e Bardhë midis Kosovës dhe Serbisë, është edhe ndërtimi i linjës hekurudhore, Prishtinë - Merdarë. Vlera e këtij segmenti hekurudhor me gjatësi prej 45 kilometra arrin në 150 milionë euro, ka thënë në një intervistë për "Rel", më 9 shtator, ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi.
"Këtu e kemi lënë të hapur mundësinë, nëse traseja ekzistuese do të jetë apo do të bëhet trase tjetër, pasi që dihet që në pjesën që kalon nëpër Prishtinë, ky rrjet apo kjo rrugë ka pasur ndërhyrje të mëdha. Po ashtu edhe tuneli që është i dëmtuar, merr një kosto të madhe të rehabilitimit. Pra, varësisht nëse është kjo trase apo tjetër, ndryshon edhe kostoja", ka thënë ministri Abrashi.
Kompania "Infrakos" merret me infrastrukturën hekurudhore në Kosovë. Ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv në këtë kompani, Xhevat Ramosaj, nuk ka pranuar të prononcohet për "Rel" lidhur investimet në këtë hekurudhë.
Por, në një raport të publikuar nga "Infrakos" lidhur me projektet zhvillimore dhe Linjën e 10-të hekurudhore për periudhën korrik - gusht 2020, thuhet se "ka filluar hartimi i projekt-dizajnit preliminar për rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e linjën së 7-të hekurudhore (kufiri me Serbinë - Podujevë - Prishtinë - Fushë Kosovë). Ky projekt-dizajn është në përfundim e sipër, ndërsa afati i përfundimit varet nga situata në terren për shkak të pandemisë me Covid 19".
Transporti hekurudhor në Kosovë është një nga sistemet më të dobëta në rajon, edhe pse viteve të fundit ka filluar modernizimi i tyre, të financuara me kredi dhe subvencione nga Bashkimi Evropian.
Në fillim të vitit 2019, ka filluar rehabilitimi i segmentit të parë hekurudhor në relacionin, Prishtinë -Hani i Elezit në kufi me Maqedoninë e Veriut dhe pritet të përfundojë në fillim të vitit tjetër. Në ndërkohë është paralajmëruar që së shpejti do të fillojë edhe linja e dytë, që përfshin rrjetin hekurudhor Prishtinë - Leshak, në kufirin me Serbinë.
Kjo linjë, që ndryshe njihet si "Korridori i 10-të", përkatësisht hekurudha që shkon nga kufiri më Maqedoninë e Veriut, përshkon Kosovën dhe kalon në Serbi dhe lidh Kosovën me vendet e Evropës Perëndimore. Kjo linjë është e gjatë 148 kilometra.
Në kohën kur ka filluar ky projekt, kryeshef ekzekutiv në "Infrakos" ka qenë Agron Thaçi. Ai në një bisedë për "Rel" thekson se i gjithë projekti do të kushtojë rreth 208 milionë euro dhe pritet të përfundojë në vitin 2024. "Nga këto mjete, gjysma e tyre janë grante, janë mjete pa kthim, kurse gjysma tjetër janë kredi nga dy banka, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) si dhe Banka Evropiane për Investime, me interesa jashtëzakonisht të ulëta", është shprehur Thaçi. Aktualisht, në qarkullim janë vetëm dy linja, nëpër të cilat kalojnë trenat e Kosovës. Linja Prishtinë - Hani i Elezit, si dhe linja që qarkullon dy herë në ditë në relacionin Prishtinë - Pejë.

### A mund të futet Kosova në borxh publik

Nëse Kosova futet në kredi për realizmin e projekteve infrastrukturore, atëherë do të rritej borxhi publik. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, Kosova ka shkallën më të ulët të borxhit publik, krahasuar me vendet e rajonit. Borxhi publik, sipas këtyre të dhënave, në vitin 2019 ka arritur në 1.2 miliard euro. Në Ligjin për borxhet publike në Kosovë thuhet se në asnjë rast shuma e papaguar e borxhit të përgjithshëm nuk duhet të tejkalojë 40 për qind të Bruto Produktit Vendor.
Haki Shatri, ekspert i ekonomisë, thotë se Kosova ka hapësirë për të hyrë në borxh publik. "Nëse marrim kredi për këto projekte do të rritet borxhi publik i Kosovës, por nuk e dimë se sa janë. Sipas ligjeve tona në fuqi, Kosova ka hapësirë për të hyrë në borxhe publike deri në 40 për qind të BPV-së. Ne tani jemi 17 për qind të ngarkuar me borxhe, kështu që kemi një hapësirë të madhe", thotë ai.

### Kosova shpenzoi 1.4 miliard euro nga buxheti për autostrada

Vitet e fundit infrastruktura ka mbizotëruar investimet në Kosovë. Përveç ndërtimit të rrugëve lokale e magjistrale, janë ndërtuar edhe autostrada që lidhin Kosovën me vendet e rajonit dhe të Evropës. Përqindja më e madhe e buxhetit të Kosovës zakonisht është ndarë pikërisht për ndërtimin e autostradave.
Autostrada 'Ibrahim Rugova', e cila ishte lëshuar në qarkullim në fund të vitit 2013, ka kushtuar mbi 820 milionë në euro. Mjetet për këtë autostradë ishin të buxhetit të Kosovës. Vetëm një vit më vonë, më 2014, patën nisur punimet e autostradës e cila shtrihet nga Prishtina në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut. Inaugurimi i kësaj autostrade ishte bërë në maj të vitit 2019 dhe buxhetit të Kosovës i ka kushtuar mbi 600 milionë euro.
Konsorciumi turko-amerikan 'Bechtel-Enka' i ka ndërtuar të dyja autostradat në Kosovë.

# 1 miliard euro janë humbjet në sektorin privat për shkak të Covid-19



PRISHTINË, 27 SHTATOR - Përkundër që qarkullimi i bizneseve ka shënuar rënie mbi 1 miliard euro në pandemi, deputetët të cilët paguhen nga taksapaguesit nuk janë llogaridhënës për miratimin e planit për rimëkëmbje ekonomike që parasheh edhe tërheqjen e 10 për qind të kursimeve në Trust. Kështu ka thënë drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, derisa ka shtuar se kjo situatë duhet të shihet si mjaft shqetësuese nga ligjvënësit për dëmin që është shkaktuar nga pandemia Covid-19. "Deri tani me të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës pothuajse qarkullimi i përgjithshëm i ndërmarrjeve në Kosovë ka shënuar një rënie prej 1 miliard eurosh që për një shtet me një brutoprodukt më të vogël në rajon, ky një miliard deri më tani do të duhej të shihet me dramacitet nga ana e vendimmarrësve", ka thënë Zeka për "Kosovapress".
Përveç në sektorin privat, Zeka ka thënë se mosmiratimi i Projektligjit për rimëkëmbje ekonomike ka ngjallur pakënaqësi edhe nga ana e qytetarëve për mosrealizimin e paraparë të mjeteve nga Trusti. Ai ka thënë se kërkohet nga koalicioni qeverisës që të arrijë një konsensus edhe me partitë e tjera opozitare që të votohet plani për rimëkëmbje ekonomik.

# 369 fermerë, kultivues të grurit, përfitojnë nga sasia e 150 000 kilogramëve të plehut artificial

Ferizaj, 27 shtator (ER) - Si asnjëherë më parë, bujqit dhe fermerët ferizajas kanë vëmendjen e qeverisjes lokale të udhëhequr nga kryetari Agim Aliu. Janë të shumta thirrjet publike për subvencione, mekanizëm bujqësor e gjithë nevojat që kanë fermerët përgjatë gjithë kësaj periudhe qeverisje, që ka bërë që përfitues të jenë mijëra fermerë dhe bujq ferizajas.
Së fundmi, është thirrja publike për përkrahjen e fermerëve me pleh artificial që ka publikuar Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Ferizaj. E shpërndarjen e saj e bënë zyrtarët e kësaj drejtorie, prirë nga drejtori i Bujqësisë, Burim Bajrami.
Ky i fundit tha se drejtoria që udhëheq po shpërndan 150 000 kilogramë pleh artificial NPK 15:15:15 për kultivuesit e grurit të cilët kanë dorëzuar kërkesat e tyre në drejtori pas shpalljes së thirrjes për aplikim. Ai ka shtuar se kjo mbështetje është e vazhdueshme dhe, si e tillë, po shpërndahet në mënyre proporcionale dhe do të vazhdojë edhe në ditët në vazhdim.
Bujqit dhe fermerët ferizajas kanë mbështetjen e plotë nga autoritetet komunale, si asnjëherë më parë, që përmes ndihmës konkrete ta ngrehin, zhvillojnë dhe ta arrijnë mirëqenien me prodhimet që kultivojnë.



# 22 vjet nga rënia e tre dëshmorëve dhe 29 martirëve të Abrisë së Epërme



Drenas, 27 shtator (ER) - Me rastin e shënimit të 22-vjetorit të rënies së tre dëshmorëve, Valdet Xhemajli, Vesel Demaku e Afrim Hajdari, si dhe 29 martirëve anëtarë të familjes Deliu, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, së bashku me bashkëpunëtorë dhe përfaqësues të subjekteve politike në Drenas dhe familjarë të të rënëve, kanë bërë homazhe në varrezat e dëshmorëve në Abri dhe në kompleksin e martirëve të familjes Deliu dhe kanë vendosur buqeta me lule të freskëta.
Kryetari Lladrovci ka thënë se rënia e dëshmorëve dhe martirëve mbetet historia më e lavdishme e Kosovës dhe se kushdo që i konteston vlerat e luftës çlirimtare së pari duhet t'i vizitojë vendet ende të freskëta të rënies së tyre.
Më 26 shtator të vitit 1998 forcat serbe kryen njërën prej masakrave më të rënda të luftës, atë mbi familjen Deliu në fshatin Abri të Drenasit, në të cilën nuk kursyen foshnjat, gratë e të moshuarit. Edhe pas 22 vjetësh drejtësia ende nuk ka vepruar për t'i ndëshkuar planifikuesit dhe ekzekutuesit e kësaj masakre dhe masakrave të tjera në Komunën e Drenasit.

# Abrashi dhe Ahmeti përcjellin punimet te rrethrrotullimi në rrugën nacionale N2 Prishtinë - Ferizaj

Lipjan, 27 shtator (ER) - Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, dhe ministri i Infrastrukturës, Arban Abrashi, kanë përcjellë të dielën punimet te rrethrrotullimi në rrugën nacionale N2 Prishtinë - Ferizaj, gjegjësisht në fshatin Banullë.
Kryetari Ahmeti ka falënderuar ministrin Arban Abrashi dhe zëvendësministrin Arton Retkoceri për kontributin e tyre nëpër realizimin e këtij projekti dhe ka theksuar se ndërtimi i një rrethrrotullimi të tillë është i një rëndësie të veçantë për qytetarët e Komunës së Lipjanit, po ashtu edhe për ata të Kosovës, sepse do të rritet niveli i sigurisë në këtë rrugë.
Vlera e këtij projekti kap shumën rreth 400 mijë euro dhe do të financohet nga Ministria e Infrastrukturës.



# Mbahet festivali tradicional kombëtar "Anadrinia Jehon 2020"



Rahovec, 27 shtator (ER) - Në fshatin Dejnë, për të nëntëmbëdhjetin vit me radhë, filluan të jehojnë kënga dhe vallja popullore për t'i shpalosur vlerat më të mira popullore të kombit tonë. Këtë vit, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, festivali është mbajtur në mënyrë virtuale më 25 dhe 26 shtator, për t'i shpalosur kështu vlerat më të mira popullore të kombit tonë.
Kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka thënë se Festivali i Folklorit "Anadrinia Jehon" është pjesë e trashëgimisë sonë kulturore, por edhe historike. "Banorët e kësaj zone tashmë janë mishëruar me këtë ngjarje dhe kjo është bërë pjesë e pandashme e vlerave tona kulturore. Me këtë rast duhen përgëzuar entuziastët e kulturës e traditës sonë popullore për mundin dhe përkushtimin e tyre, si dhe grupet pjesëmarrëse nga të gjitha viset shqiptare. Duke parë këtë entuziazëm, qeveria komunale e Rahovecit ka ndarë mjete materiale dhe financiare për krijimin e kushteve sa më të mira për mbarëvajtjen e kësaj feste kombëtare", ka thënë Latifi.

# Doan Tahirbegolli zgjedhet kryetar i ARK-së në Pejë

Pejë, 27 shtator (ER) - Doan Tahirbegolli është zgjedhur kryetar i Aleancës së të Rinjve të Kosovës (ARK) në Pejë. Emri i Tahirbegollit ka dalë si propozim nga Kuvendi i Jashtëzakonshëm, i mbajtur të shtunën, me ç'rast ka marrë përkrahjen e të gjithë delegatëve të pranishëm, pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.
Në kuadër të këtij kuvendi janë zgjedhur edhe tre nënkryetarë: Flamur Selfijaj, Flaka Kuqi dhe Denis Gashi, sekretari i përgjithshëm: Eroll Krasniqi si dhe Dëbora Agusholli në cilësinë e sekretares së përgjithshme të Aleancës së të Rinjve në Pejë.



# ‘Kemi nevojë për të majtën e vërtetë…’



Shkruan: Bedri ISLAMI

Në ditët e fundit, krejt befas por, jo rastësisht, ndodhën disa lëvizje të ndjeshme, të cilat turbulluan mjaft ujëra dhe, si duket, qetësimi i tyre do të jetë i vështirë. Dy nga ministrat kryesorë të qeverisë Rama, njëri pas tjetrit, fillimisht ajo e Arsimit, Besa Shahini dhe, menjëherë pas saj, ai i Punëve të Brendshme, Sander Lleshi, deklaruan se nuk do të jenë më pjesë e qeverisë së të majtës, edhe nëse ajo do të fitojë zgjedhjet e 25 prillit të vitit të ardhshëm.
Megjithëse që të dy, përsëri njëri pas tjetrit, deklaruan se e ardhmja e Shqipërisë e kërkon që e majta dhe Rama të qeverisin edhe në mandatin e tretë, si e vetmja rrugë për daljen nga gjendja e krijuar, përsëri shija që lanë pas vetes ishte e hidhur.
Sado që mes tyre dhe shefit të qeverisë të ketë pasur një diskurs të përbashkët qëndrimi, shpallja privatisht, si të lajmëronin se po iknin nga një ndeshje futbolli, të çon në një problem që është edhe më ndjeshëm se sa kaq: Ardhja e beftë në radhët e së majtës të një ciklimi njerëzish, të cilët, deri pak më parë, ose kanë qenë në aneksin e së majtës, ose nuk kanë pasur asnjë lidhje me të.
Ata, si deklaroi në debatin e parë televiziv zoti Lleshi, më shumë e kishin marrë përsipër detyrën si një detyrim mbështetje ndaj shefit të qeverisë, ose, në rastin e zonjës Shahini, si një prurje nga viset shqiptare të Përtejdrinit, një zgjidhje e njohur deri në vitin 1924, kur në parlamentin shqiptar kishte deputetë nga këto zona, ndonjëri nga të cilët, si Hoxhë Kadriu, do të ishte ministri i parë i drejtësisë në qeverinë e Lushnjes.
Shahini, një ministre e pabujë dhe, si pak herë, pa asnjë skandal mbi vete, më shumë e ndjekur nga iluzionet për shtetin amë, si ish anëtare e Lëvizjes VV që kishte qenë dikur, mendoi se koha për t’u kthyer në familjen e saj kishte ardhur, dhe këtë, e shpalli si një lajm vetjak, e perceptueshme për të, normale njerëzisht, por e pagjetur dhe e pajustifikuar politikisht dhe për nga besimi që i ishte dhënë.
Ministri Lleshi, dorë e fortë, me një ngjasim bonopartian në fillimet e ditëve të tij si ministër, i qëndrueshëm në përballjen me opozitën, - njëjtë do të kishte vepruar edhe nëse përballë tij në detyrën si ministër i brendshëm të kishte pasur një opozitë socialiste, sepse ai është rob i detyrës - në largimin e tij ndjehej lodhje, puna që i ra befas mbi shpinë kishte qenë më e rëndë nga sa i ishte dukur fillimisht, terreni kishte qenë ndryshe nga zyra dhe, megjithë dëshirën e mirë, pak gjëra kishin ndryshuar.
Si për të dashur të verë një “pikë mbi i”, largohet edhe Plarent Ndreca nga detyra e tij si sekretar i përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, edhe ai një figurë e ardhur rishtas në të majtën dhe më shumë i njohur si militant i tenderëve, se sa i së majtës.
Edhe në disa dikastere të tjerë drejtuesit janë më shumë përzgjedhje e shefit të qeverisë, se sa njerëz që kanë lidhje të ndjeshme, bazike dhe të qëndrueshme me të majtën.
Një president i madh francez, Miteran, ndoshta më i kulturuari dhe më autoritari në postin e tij, kur do të kandidonte për të majtën në postin e Presidentit të Republikës Franceze bëri kërkesën e tij në strukturat e partisë: T’i jepnin në fushatën e tij 200 militantë, që të ishin përkrah tij, të ndriçonin rrugën që do të bënte, të sillnin ide dhe të kishin vizionin e duhur për të ardhmen.
E majta në pushtet, pas dy mandatesh dhe pas lodhjes qeverisëse, ka nevojë pikërisht për tërheqjen, në pushtet ose rreth tij, të njerëzve militantë - jo mitingashë e as të përkohshëm - të cilët u përkasin ideve të së majtës evropiane, njerëz me personalitet të fuqishëm, që nuk kanë droje të kundërshtojnë shefin e tyre, të ecin në këmbë drejt shtëpisë dhe të jenë të mbrojtur mbi të gjitha nga opinioni i popullit.
Të çastit apo të përkohshmit në qeverisjen e së majtës, të cilët, po aq shpesh sa kujtohen, aq shpejt edhe harrohen, ose edhe më tej, bëjnë më pas opozitarin pikërisht ndaj forcës politike që i bëri njerëz e me emër, e jo pak herë edhe të pasur, shpesh herë bëjnë diçka që ndjehet tek votuesit e kësaj force politike: largimin dhe ftohjen. Nëse në qeveri apo në drejtori të rëndësishme janë thirrur njerëz që nuk kanë asgjë të përbashkët me të majtën dhe, më tej, as nuk e dinë programin apo vizionin e saj, atëherë edhe pak mund të pritet.
Emërimi i zotit Erion Braçe, në postin e zëvendëskryeministrit, u prit me duartrokitje nga Këshilli Kombëtar i PS-së dhe ishte i vetmi emërim që u prit kësisoj, sepse , edhe për këtë forum, disa nga të emëruarit e që më pas ngritën duart e miratimit, nuk ishin të njohur dhe disa prej tyre as që i kishin parë ndonjëherë.
Qeverisja tetëvjeçare e së majtës ka sjellë ndryshim në forcimin e konceptit të shtetit, por edhe ka rritur ndikimin e oligarkisë pushtetore në mekanizmat ekonomikë. Të qeverisësh tetë vite, duke pasur mbi vete tri gremina e kriza të mëdha: greminën financiare të vitit 2013, që ishte qindra milionë euro dhe për të cilën më pas, arkitekti i saj, Bode, u “delegua” në Bordin e Bankës Shqiptare, tërmetin e nëntorit 2019 dhe pandeminë e frikshme të këtij viti, do të thotë të mos jesh në të njëjtat kuota besimi ku edhe ke nisur qeverisjen. Duke i shtuar këtyre edhe mosndëshkimin e së keqes dhe pranimin e saj si mjet kompensimi politik, tenderët e frikshëm dhe të pakapshëm, atëherë nevoja për një ndryshim drejt afrimit të atyre që janë në të vërtetë njerëz të devotshëm, të ditur dhe të afeksuar ndaj vendit, është domosdoshmëri.
Thirrja e çastit, nganjëherë me kohë të pjesshme e një numri të panjohur figurash që bëhen politike vetëm pasi emërohen në poste të larta, nuk e afron as Rilindjen dhe as të Majtën me bazën e saj, përkundrazi e largon. Një votues që nuk di as gjysmën e emrave të qeveritarëve për të cilët ka votuar nuk mund të ngrohet më vetëm nga figura e shefit të qeverisë: tani ai kërkon ekipin dhe këtë ekip e kërkon mes vetes, tek njerëzit që ai i njeh krejt mirë, që i ka provuar, që janë militantë të së Majtës e jo mitingashë, që kanë ide dhe jo synimin përfitues, që janë të denjë për një vizion ndryshe dhe jo klloçkitës në furrikun qeveritar.
E Majta në Shqipëri jo pak herë ka vuajtur pikërisht nga kjo mendësi politike: besimin e çastit, pa e ditur se në cilën provë ka shkuar, çfarë bagazhi ka dhe çfarë synimi drejt të tjerëve.
Që nga themelimi i saj, ose më saktë, që nga Kongresi i parë i saj, e Majta në Shqipëri është shquar për grumbullimin rreth vetes të një brezi epokal të intelektualizmit shqiptar. Më shumë se gjysma e kryesisë së saj të parë ishin doktorë profesorë, figura të shquara në fushat e tyre, të cilët edhe sot ndjellin respektin e besimin e njerëzve, ose kanë mbetur simbol të jetës së ndershme dhe të përkushtuar, mes tyre edhe tre kolosë që nuk janë më, Dritëro Agolli, Moikom Zeqo dhe Sabit Brokaj.
Edhe pse mund të mos jenë shumë në këto përmasa, e Majta ka mundësinë të grumbullojë rreth vetes pikërisht këto vlera, të cilët, aq sa i bëjnë nder asaj, aq janë të dobishëm për këtë vend.
Rrugë tjetër nuk ka.

# UÇK-ja është margaritar i qytetërimit evropian



Shkruan: Faton ABDULLAHU

UÇK-ja është vlerë e qytetërimit evropian. Në të vërtetë, UÇK-ja është margaritar i qytetërimit perëndimor në përgjithësi. A kam të drejtë të konstatoj kështu?
Kur kah fundi i shekullit të kaluar interesat gjeopolitike ruse janë konsoliduar për ta mbrojtur Jugosllavinë nga shpërbërja, si kusht i shtrirjes dhe rikthimit të tyre në Ballkan, përmes unitarizmit jugosllav të Milloshevigit shqiptarët janë rreshtuar kundër këtij projekti. Faza më e lartë dhe më bindëse e këtij rreshtimi të shqiptarëve ka qenë përgjigjja me luftë, konkretisht lufta e UÇK-së (natyrisht edhe e UÇPMB-së dhe UÇK-së në Maqedoni). Shqiptarët në Jugosllavi nuk kanë mundur ta bëjnë këtë pa luftë, siç e bënë polakët me ‘Solidarnostin’ dhe Leh Valensën, as si çekët me Vacllav Havellin, bile as si rumunët me vrasjen e kryetarit të tyre Qausheskut. Është dashur edhe një hap tutje. Është dashur të bëhet lufta për liri me armë në dorë, sepse kishim të bënim me një shtet që ofronte vetëm robëri me dhunë. Jugosllavia kurrë nuk ka qenë shtet demokratik. Ajo u ka bërë ballë shumë epokave dhe ndryshimeve, por jo demokracisë. Thjesht, Jugosllavinë e ka shpërbërë liberal demokracia euro-perëndimore. Si askund në Evropën Lindore, kjo në Kosovë nuk ka mundur të ndodhë kurrë pa luftë.
Kundër interesave ruse në Ballkan, kundër Milloshevigit si vazhdim i këtyre interesave, në anën tjetër për liberal demokracinë perëndimore dhe për gjeopolitikën euro-atlantike, ka dalë UÇK-ja me pushkë në dorë. Ashtu si dikur Skënderbeu i cili iu priu shqiptarëve me shpatë në dorë, për lirinë e tyre dhe e mbrojti Evropën duke ndalur hyrjen e osmanëve në kontinent, ashtu edhe UÇK-ja doli për lirinë e shqiptarëve dhe kundër interesave anti-evropiane ruso-serbe në këtë rajon të Evropës. Prandaj, Skënderbeu është çmuar gjithmonë nga Evropa dhe krejt perëndimorët, për të njëjtën arsye nga të njëjtët çmohet lufta e drejtë e UÇK-së dhe shteti i Kosovës që i ka themelet te kjo luftë dhe ky rreshtim. Ajo çfarë bëri EULEX-i të premten (javën që lamë pas) në Prishtinë dëshmoj se e ka harruar këtë të vërtetë, për më keq se po kthehet kundër kësaj historie të lavdishme evropiane.

# Aktori i famshëm turk publikon imazhin e parë me të birin



Aktori i famshëm turk Burak Ozçivit dhe bashkëshortja e tij Fahriye Evçen u bënë prindër për herë të parë vitin e kaluar. Ajo solli në jetë djalin të cilin e pagëzoi Karan. Çifti kishte vendosur që lidhjen e tyre me fëmijën ta mbajnë sa më private. Së fundmi për herë të parë Burak ka vendosur ta publikojë një fotografi me të birin ku shihet duke e mbajtur në krah.

# Max Ehrich thotë se Demi nuk i ka treguar se do të ndahet nga ai



Max Ehrich është hapur për herë të parë rreth ndarjes me Demi Lovato, dy muaj pasi u fejuan. Ai kishte thënë se këngëtarja nuk i ka treguar se do të ndahet, derisa një vendim i tillë e ka surprizuar, shkruan "Mirror". Në një postim në rrjetin social "Instagram", ai shkroi: Imagjinoni ta kuptoni statusin e marrëdhënies tuaj përmes gazetave". 29-vjeçari dhe Demi kishin filluar lidhjen e tyre gjatë muajit mars, ndërsa kaluan së bashku kohën gjatë pandemisë koronavirus. Ndërsa lajmet për ndarjen e tyre kanë filluar që në fillimin e kësaj jave, teksa Demi shfaqej në rrjete sociale pa unazën e fejesës.



# Beatrix dhe Anxhelina shijojnë pushimet në Dubai

Këngëtaret e njohura të estradës shqiptare, Beatrix dhe Anxhelina, janë të njohura për jetën luksoze që bëjnë. Së fundmi dyshja kanë vendosur që për pushime të kenë destinacion Dubain. Në një postim të fundit nga Ramosaj, bukuroshet janë shfaqur nga shkretëtira Red Sand derisa merrnin poza para kamerës. Që të dyja janë parë në një motoçikletë teksa me veshjet provokuese u theksoheshin tiparet trupore.

# Fero heq dorë nga muzika



Reperi shumë i famshëm dhe i zhurmshëm shqiptar Fero ka thënë se ka hequr dorë nga muzika. Fero ditë më parë mbylli rrjetet sociale duke përhapur panik te fansat e tij, e për Insajderi.org ka dhënë një deklaratë shokuese. I pyetur se pse e ka mbyllur "Instagram"-in, reperi ka thënë: "Jam larguar nga rrjetet sociale sepse kam hequr dorë nga muzika". Reperi nuk ka dhënë përgjigje nëse është larguar nga muzika përkohësisht apo përgjithmonë, e as nuk dha arsyet se pse e ka marrë këtë vendim.




# Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

# Gjilani dhe Ballkani ndajnë pikët, Arbëria kryeson Superligën



EPOKA E RE — Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Derbi i xhiros së tretë në Superligën e Kosovës në futboll në mes të Gjilanit dhe Ballkanit përfundoi pa fitues dhe pa gola të shënuara (0-0). Ndeshja e zhvilluar në stadiumin e qytetit në Gjilan solli lojë të bukur dhe raste shënimi, por në fund skuadrat i ndan pikët. Meriton Korenica provoi të shënojë pas gjashtë minutave lojë por, pa sukses. Në minutën e 17-të Blend Baftiu doli në rast të mirë shënimi, por goditja përfundimtare ishte e dobët dhe rezultati mbeti i pandryshuar.
Edison Kqiku i vendësve ishte afër shënimit në minutën e 25-të, por Sinani e largoi topin nga vija e portës. Pak para fundit të pjesës së parë, Korenica doli në rast shënimi, megjithatë golin ia mohoi portieri Kolici. Rezak i Gjilanit në minutën e fundit të pjesës së parë nuk e shfrytëzoi mundësinë që kishte dhe skuadrat shkuan në pushim me rezultat 0-0. Në pjesën e dytë Kolici e shpëtoi në dy raste Gjilanin, duke pritur gjuajtjet e Korenicës dhe Dakut. Ndërsa Haxhihamza ia mohon golin Prognit. Mundësinë më të mirë Gjilani e kishte në minutën e 74-t, kur Hajdari e shërben për mrekulli Shend Kelmendin, por ky i fundit gjuan jashtë portës.
Të shtunën janë zhvilluar dy ndeshje të Superligës. Trepça '89 e ka shijuar fitoren e parë në këtë edicion, pasi e ka mposhtur Llapin në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Riza Lushta" me rezultat 1-0. Golin e fitores për "minatorë" e realizoi sulmuesi Arb Manaj në minutën e 39 pas asistimit të Muharrem Jasharit. Ndërkaq, ndeshja derbi e dy skuadrave drenicase, Feronikelit dhe Drenicës që u luajt në stadiumin "Rexhep Rexhepi", u mbyll pa fitues (2-2). Almedin Murati shënoi të dyja golat për Drenicën (27' e 80'), kurse për Feronikelin realizuan Albert Dabiqaj (58') dhe Marko Milickoviq (72').

### Dukagjini mposhti Vëllanzimin

Skuadra e Dukagjinit të Klinës e ka fituar ndeshjen kryesore në Ligën e Parë ndaj Vëllaznimit në Gjakovë (0-1), kurse golin e fitores e shënoi Granit Elezaj në minutat shtesë të ndeshjes. Ferizaj ka luajtur baras me KEK-un (0-0), ndërsa pikët i kanë ndarë edhe Flamurtari dhe Vllaznia e Pozharanit (1-1).

**SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Gjilani - Ballkani | 0-0 |
| Trepça '89 - Llapi | 1-0 |
| Feronikeli - Drenica | 2-2 |
| Besa - Arbëria | 0-3 |
| Prishtina - Drenica | 0-0 |

**TABELA**

| | | PIKË |
|---|---|---|
| 1. Arbëria | 3 | 7 |
| 2. Ballkani | 3 | 7 |
| 3. Feronikeli | 3 | 4 |
| 4. Prishtina | 2 | 4 |
| 5. Drenica | 3 | 4 |
| 6. Gjilani | 3 | 4 |
| 7. Trepça '89 | 2 | 3 |
| 8. Drita | 0 | 0 |
| 9. Llapi | 2 | 0 |
| 10. Besa | 3 | 0 |

**LIGA E PARË**

**GRUPI A**

| | |
|---|---|
| Drenasi - Trepça | 0-0 |
| Istogu - Liria | 2-0 |
| Vushtrria - A&N | 1-0 |
| Vëllaznimi - Dukagjini | 0-1 |
| Malisheva - Onix Banja | 1-2 |

**GRUPI B**

| | |
|---|---|
| Ramiz Sadiku - Kika | 0-1 |
| Ulpiana - Vitia | 2-0 |
| Ferizaj - KEK-u | 0-0 |
| Dardana - 2 Korriku | 1-0 |
| Vllaznia - Flamurtari | 1-1 |

## SHKURT

### Januzaj shënon golin në këtë edicion

Futbollisti shqiptar Adnan Januzaj ka realizuar gol në fitoren e Real Sociedadit ndaj Elches në xhiron e tretë të La Ligas. Futbollisti nga Kosova shënoi golin e dytë të ndeshjes. Ai u tregua i saktë nga pika e bardhë në minutën e 77-të, në penaltinë që e fitoi vetë. Ky ishte goli i tij i parë këtë sezon. Sociedadi fitoi ndeshjen me rezultat 3-0 si mysafir.

### Quartararo arrin edhe një fitore në Grand Prixin e Katalonisë

Piloti i Yamahas, Fabio Quartararo, ka regjistruar një tjetër sukses këtë edicion. Grand Prixi i Katalonisë i ka takuar pilotit francez Fabio Quartararo, i cili prapa vetes la Mir dhe Rins. Anëtari i Yamahas me këtë fitore ka dëshmuar se vazhdon të jetë emri kryesor për titullin e kampionit, në mungesë të Marc Marquezit, ky i fundit që pësoi një dëmtim në fillim të kampionit. Me fitoren në këtë garë, Quartararo tashmë prin në kampionatin me tetë pikë më shumë sesa Joan Mir. Alex Rins kompletoi podiumin në garën e sotme, duke u bërë kështu piloti i 13 që arrin podiumin këtë edicion.

### Bale: Nuk isha i lumtur në Real

Gareth Bale ka folur pas një jave që është rikthyer në Londër dhe po luan me Tottenhamin. Sulmuesi duket më i lumtur që pas largimit nga spanjollët dhe rikthimit te "Spursat". "Jam shumë i lumtur që u riktheva sërish sepse e dua këtë klub. Kam kujtime shumë të mira dhe ndihem mirë dhe kam besimin e klubit. Niveli im i energjive po shkëlqen sërish", ka thënë Bale. "Reali? Dua ta shijoj futbollin tim. Në Madrid vuajta për pak kohë. Të gjithë e panë. Kur nuk je i lumtur është e vështirë që të luash në nivelin më të mirë. Jam shumë i qetë dhe mundohem ta mbaj veten larg kamerave dhe mediave. Kjo ndoshta nuk u pëlqeu atyre", ka shtuar Bale.

## FFK-ja, klubeve: Respektojini masat anti-Covid

PRISHTINË, 27 SHTATOR - Federata e Futbollit e Kosovës të dielën ka kërkuar nga të gjitha klubet që ta respektojnë në mënyrë strikte protokollin dhe masat anti-Covid në mënyrë që të mos vijë deri te ndërprerja e aktiviteteve. "Organet kompetente tashmë i kanë dhënë vërejtje serioze FFK-së për mosrespektimin e këtij protokolli në disa prej ndeshjeve të zhvilluara deri më tash dhe në rast se një gjë e tillë përsëritet, atëherë do të bëhet pezullimi i aktiviteteve", thuhet në njoftimin e FFK-së. Federata e Futbollit u ka bërë thirrje të gjitha klubeve që të jenë vigjilente dhe strikte për përmbushjen e të gjitha obligimeve që dalin nga protokolli i institucioneve shëndetësore në luftën kundër Covid-19, derisa kërkon nga të gjithë personat zyrtarë dhe organet e saj që të mos lejojnë fillimin e asnjë ndeshjeje në rast se do të ketë persona të paautorizuar në stadiumet e futbollit.

## Hamiltoni zhgënjen në Sochi, triumfon Bottas

SOCHI, 27 SHTATOR - Piloti finlandez i skuadrës gjermane Mercedes, Valteri Bottas, konfirmohet si specialist i garave të Sochit, pasi ia doli të triumfojë edhe në pasditen e sotme, ndonëse u nis nga vendi i dytë, pas shokut të tij Lewis Hamilton. Ky i fundit bëri një garë zhgënjyese dhe mori edhe dy penalitete 5-sekondëshe, duke e mbyllur vetëm në vendin e tretë dhe duke mos arritur të barazojë me Michael Schumacherin me 93 fitore në Formulën 1. Vendi i dytë këtë herë shkoi për pilotin e Red Bullit, Max Verstappen, ndërsa makinat Ferrari vijojnë të dhurojnë performanca zhgënjyese, me Leclerc që e mbylli garën i gjashti dhe Vettel i 13-i.



# Turneu 'Lah Nimani' zhvillohet në fundjavën e ardhshme



PRISHTINË, 27 SHTATOR - Me masat e reja të vendosura nga Qeveria e Republikës së Kosovës, është lejuar edhe zhvillimi i garave sportive në nivel vendi. Me këtë rast, Federata e Boksit e Kosovës ka mbajtur seminarin për gjyqtarë, delegatë dhe mjekë sportivë, ku edhe janë pranuar tre gjyqtarë të rinj në Shoqatën e Gjyqtarëve të Kosovës. Në një intervistë për "KosovaPress", nënkryetari i kësaj federate, Sylë Voca, ka deklaruar se ky seminar është tejet i nevojshëm për avancimin dhe përshtatjen e gjyqtarëve me rregullat e reja. Ai, po ashtu, ka bërë me dije se turniri i boksit "Lah Nimani" pritet të zhvillohet së shpejti. "Qëllimi kryesor është rifreskimi i memories dhe të arriturave të boksit ose të Shoqatës së Referëve të Federatës së Boksit për ndryshimet që kanë ardhur nga Federata Botërore e Boksit dhe nga Federata Evropiane, ndërkohë edhe gjatë kohës së pandemisë ka pasur disa ndryshime jo shumë të mëdha, por të vogla që duhet të pajisen me ato njohuri kur dihet që referët janë pjesa kruciale e zhvillimit të boksit në Kosovë", ka thënë Voca, i cili më tuje ka treguar se ka disa ndryshime në rregullore të cilat kanë ardhur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar që kanë ndodhur brenda kësaj periudhe dhe këta duhet të ecin në hap me kohën. "Ka disa ndryshime në rregullore të cilat kanë ardhur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar që kanë ndodhur brenda kësaj periudhe dhe këta duhet të ecin në hapa me kohën me rregullat e AIBA-s dhe OBC-së, prandaj janë të mirëseardhura dhe të domosdoshme që të pajisen me këto rregulla që janë të obligueshme edhe për federatën tonë", ka shtuar Voca.

Në fund, Voca ka folur edhe rreth kohës se kur mund të zhvillohet turneu i boksit "Lah Nimani" i pezulluar për shkak të pandemisë. "Ne asnjëherë nuk kemi pushuar sa i përket zhvillimit dhe masivizimit të boksit tonë, por garat kemi qenë të detyruar të mos i zhvillojmë. E kemi pasur të gatshëm turnirin 'Lah Nimani' të cilin është dashur ta mbajmë para dy-tre javëve, por tani në momentin e parë që të na jepet mundësia pas lehtësimit të masave do ta mbajmë turnirin 'Lah Nimani' i cili do të jetë një sprovë për ne se si t'i zbatojmë rekomandimet e OBSh-së dhe të ecim përpara. Nuk ka datë të caktuar definitive se kur mund të zhvillohet turniri sepse varet edhe nga orari i sallës sa është e ngjeshur, por shpresojmë që në fundjavën e ardhshme të startojmë me turnirin 'Lah Nimani'", ka deklaruar Voca.

# Lakersat, kampionë në Perëndim

ORLANDO, 27 SHTATOR - Skuadra e Los Anxhelos Lakersit është shpallur kampione në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 117-107 ndaj Denverit në finalen e pestë të "play-off"-it. Lakersat fituan 4-1 serinë e ndeshjeve, duke u kualifikuar për në "the finals" dhe siguruan të drejtën të duelojnë për titullin kampion në NBA. Lakersat rikthehen në finalet e NBA-së 10 vjet nga hera e fundit, kur skuadra asokohe drejtohej në fushë nga Kobe Bryant. Këtë herë është LeBron Jamesi ai që udhëheq skuadrën drejt titullit, duke qenë lideri i skuadrës. Këtë gjë ai e vërtetoi edhe sot, duke realizuar një "triple double" ndaj Denverit, 38 pikë, 16 rebounde e 10 asistime, më i miri në fushë, mbështetur edhe



nga Anthony Davis me 27 pikë. Ndërkohë që, 30 pikë u realizuan nga lojtarët e stolit. Për Denverin, Jokiqi dhe Granti realizuan nga 20 pikë secili, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Kualifikimi deri në finalet e Perëndimit mbetet një sukses për Nuggetsit, që largohen kokëlartë.

## SHKURT

### Beqiri dhe Krasniqi drejtuan me sukses ndeshjen e Ligës së Kampionëve

Prania e anëtarëve të Federatës së Hendbollit të Kosovës në garat evropiane po shkon duke u rritur e duke u avancuar vazhdimisht. Të shtunën ndeshje të rëndësishme të Ligës së Kampionëve për hendbolliste kanë drejtuar dy gjyqtarët kosovarë të hendbollit, Eshref Beqiri e Ilir Krasniqi. Ata për herë të parë kanë drejtuar ndeshje të garës elitare evropiane, ndërsa punën e kanë kryer me sukses të plotë. Beqiri dhe Krasniqi ishin gjyqtarë në ndeshjen në mes të skuadrës kroate, HC Podravka Vegeta dhe asaj gjermane, Borussia Dortmund. Ndeshjen e fortë dhe interesante e fitoi skuadra gjermane Borussia Dortmund me rezultatin 26:25. Ndeshja është luajtur në Koprivnica të Kroacisë. Beqiri dhe Krasniqi për delegate e kishin Arijana Vojiqin nga Bosnjë-Hercegovina. Ndeshja ishte e xhiros së tretë e Grupit B të Ligës së Kampionëve. Gjyqtarët e Kosovës edhe më herët këtë edicion kanë drejtuar ndeshje të kupave evropiane. Delegime të shumta priten në vazhdim të edicionit, si shenjë e avancimit të vazhdueshëm të anëtarëve të FHK-së.

### Schalke shkarkoi trajnerin

Schalke 04 e ka shkarkuar trajnerin David Wagner, pasi skuadra e tij i pësoi 11 gola në dy ndeshjet e para në sezonin e ri 2020/21 në Bundesligë. Skuadra e Wagnerit u turpërua 8-0 nga kampioni aktual gjerman në ndeshjen hapëse dhe u mund 3-1 nga Werder Bremeni të shtunën. Dy humbjet në kampionat detyruan drejtuesit e klubit ta largonin nga detyra 48-vjeçarin, i cili e mori drejtimin e skuadrës me 9 maj të 2019-s.

### Morata: Ronaldo ishte i lumtur që u ktheva te Juventusi

Alvaro Morata është lidhur me një ish-bashkëlojtar te Juventusi, Cristiano Ronaldon. Dyshja luajti së bashku në Real Madrid përpara se spanjolli të largohej për t'u bashkuar me Juventusin në verën e 2014-s. Pas përfundimit të një lëvizje huazimi përsëri te Juve nga Atletico Madrid, Morata foli për Cristianon. "Cristiano më tha se ishte i lumtur që po kthehesha. Unë e njoh atë mjaft mirë si një person. Si lojtar, të gjithë e njohin atë shumë mirë", ka thënë Morata.

### Rice pritet t'i bashkohet Chelseat

Chelsea pritet ta bëjë transferimin e radhës këto ditë të fundit të afatit kalimtar. Lojtari i West Hamit, Declan Rice, pritet të jetë fytyra e re në "Stamford Bridge". Sipas "Express", Chelsea ka arritur marrëveshje me lojtarin, ku Rice do të përfitojë një kontratë pesëvjeçare. Frank Lampard këtë merkato ka shpenzuar rreth 250 milionë euro dhe pritet që Rice të jetë blerja e fundit e Chelseat.

### Casillas: Gabova që u largova nga Reali

Iker Casillas është rikthyer të flasë për largimin e tij nga Real Madridi. Portieri spanjoll e cilëson largimin si një gabim nga të dyja palët. "Ne të gjithë bëjmë gabime. Si unë ashtu edhe Real Madridi morëm vendime të gabuara. Largimi im ishte një zgjedhje e gabuar nga të dyja palët. Nuk ishte vendim i mirë. Një ditë jam i sigurt se do të korrigjojmë diçka të tillë. Me Mourinhon kisha probleme dhe nuk kisha marrëdhënie të mira. Ai mendonte se unë nuk isha në nivelin e duhur për Realin, por nuk kam hatërmbetje me të", ka deklaruar Casillas.

UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
FERIZAJ

Nr. prot.: 1901/20, Datë: 25.09.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, numër 03/L-212, nenit 8 pika 3 nënpika 3.5 të Ligjit për Arsimin e Lartë, numër 04/L-037, si dhe nenit 140 pika 4 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), në përputhje me Rregulloren për procedurat përzgjedhëse për emërim, riemërim dhe avancim të personelit të rregullt akademik, Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur me 02.09.2020, vendosi që të shpallë:

## KONKURS

### Për zgjedhjen e personelit të rregullt akademik

**I. MËSIMDHËNËS NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Menaxhimi Strategjik; Menaxhimi i Operacioneve Shërbyese; Menaxhimi i Cilësisë.
2. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Ekonomi; Ndërmarrësia; Menaxhimi i Projekteve dhe Investimeve.

**II. LIGJËRUES NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE**

1. Një ligjërues për lëndët: Vizualizimi; Fotoeditimi I; Komunikimi Grafik; Bazat e Dizajnit; CAD Specializim; CAD.

### Kushtet e përgjithshme

Kushtet e përgjithshme për zgjedhjen e personelit akademik të rregullt janë të përcaktuara në dispozitat e Statutit të Përkohshëm të UShAF dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit të rregullt akademik në UShAF, Nr. prot.: 2641/19, datë: 01.08.2019.

### Dokumentet e nevojshme për aplikim:

Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:

a) Kërkesën për aplikim dhe biografinë (CV),
b) Certifikatën e lindjes,
c) Për mësimdhënës kërkohet diploma origjinale (bachelor, master/magjistraturë dhe doktoratë) ose kopjet e tyre të noterizuara, ndërsa për ligjërues kërkohen diploma dhe certifikatat e notave origjinale (bachelor, master/magjistraturë) ose kopjet e tyre të noterizuara.
d) Vendimin për nostrifikim (barasvlerën) të diplomës përkatëse (bachelor, master/magjistraturë, doktoratë) nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Kosovës, për të gjithë kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit. Nuk do të merret në konsideratë dëshmia e aplikimit për nostrifikim.
e) Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale brenda kornizës së përcaktuar me Statutin e UShAF dhe Rregulloret përkatëse.
f) Certifikatë nga organet kompetente që personi nuk është nën hetime, aktuale (origjinale).
g) Informata tjera shtesë, të cilat janë të rëndësishme për kandidatët që aplikojnë.

### Kohëzgjatja e emërimit dhe kufizimet për emërim

1. Të gjitha emërimet për tituj, si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen në përputhje me dispozitat përkatëse të Statutit të UShAF dhe ligjeve në fuqi.

### Vendimi, periudha e ankimimit dhe përmbyllja e konkursit

1. Kandidatët, të cilët janë të pakënaqur me vendimet e organeve kompetente të UShAF-it (Këshillit Mësimor/Shkencor apo Senatit), gjatë përzgjedhjes se personelit akademik kanë të drejtë ankese në dy faza:
   a) Faza e parë e ankimimit është më së largu 15 ditë nga dita e publikimit të Buletinit. Buletini do të qëndrojë i publikuar 15 ditë në Zyrën nr. 008 të UShAF dhe në ueb-faqen e UShAF. Ankesa i drejtohet Komisionit për Ankesa të Këshillit Mësimor/Shkencor në UShAF dhe do të shqyrtohet nga Këshilli Mësimor/Shkencor, më së largu 10 ditë nga dita e përmbylljes së afatit të ankimimit.
   b) Faza e dytë e ankimimit bëhet ndaj vendimt të Senatit, në afat jo më larg se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas pranimit në dorëzim të vendimit. Ankesa i drejtohet Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtresa, që shërben si instancë e parë dhe e fundit e ankimimit në UShAF. Raporti i ankesave të shqyrtuara nga Komisioni i Ankesave dhe Parashtresave i prezantohet Senatit për vendosje përfundimtare në nivel të organeve të UShAF. Propozimi i Komisionit të Senatit për Ankesa dhe Parashtresa nuk ka karakter obligativ për Senatin.
2. Pala ankuese njoftohet me shkrim lidhur me vendimin përfundimtar të Senatit.
3. Konkursi për emërim, riemërim ose avancim për personelin akademik të rregullt, duhet të përmbyllet me vendime përkatëse të Senatit të UShAF për të gjitha vendet e shpallura, në një periudhë jo më të gjatë se 175 ditë nga dita e shpalljes.
4. Për raste të veçanta, para arritjes së propozimit në Senat, me kërkesë të Rektorit, afati i të gjithë procedurës mund të zgjatet maksimalisht edhe 30 ditë.
5. Nëse konkursi nuk realizohet në tërësi apo pjesërisht brenda afatit të përcaktuar si në paragrafin 3, atëherë vendet përkatëse të parealizuara mund të rishpallen në konkursin e radhës sipas kërkesës së Fakultetit.

### Mënyra e aplikimit

1. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentet e nevojshme në formë të shtypur dhe në formë elektronike.
2. Dokumentacioni në formë fizike ( i shtypur), për çdo vend pune në të cilin aplikon kandidati, përveç atij origjinal ose të noterizuar, duhet të dorëzohet edhe një kopje e thjeshtë fizike shtesë.
3. Dokumentacioni i shtypur duhet të dorëzohet në administratën e UShAF-it, zyra nr. 008, kurse versioni elektronik në adresën zyrtare të UShAF (info@ushaf.net).
4. Punimet shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare duhet të skanohen në tërësi, ndërsa për libra të botuar duhet të skanohet faqja e parë e librit dhe faqja në të cilën shihet katalogimi i botimit.
5. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara, si dhe ato që nuk deponohen të skanuara përmes postës elektronike në adresën e lartëcekur, nuk do të merren në shqyrtim.

1. Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit në shtypin ditor, përkatësisht nga data 28.09.2020 deri më 12.10.2020, ora 16:00.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**

▶ Naile Demiri, shpallë të pavlefshme diplomën Master, e diplomuar më 8 nëntor 2010, në drejtimin: Letërsi shqipe, Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

## Republika e Kosovës

**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:**

### K O N K U R S

**Për zgjedhjen e kryesuesit të Komisionit Shqyrtues në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit**

Sipas Ligjit nr. 05/L -042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Komisioni Shqyrtues përbëhet nga kryesuesi i zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, një anëtar i emëruar nga Autoriteti dhe një anëtar i emëruar nga ofruesi i shërbimeve, i cili ka parashtruar kërkesën për shqyrtim.

**Mandati i kryesuesit të Komisionit Shqyrtues:**

Kryesuesi i Komisionit Shqyrtues zgjidhet për mandat 3 (tre) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat.

**Kandidati për kryesues të Komisionit Shqyrtues duhet të plotësojë kushtet si në vijim:**

- të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- të këtë së paku diplomë universiteti 4 (katër) vjeçar ose master;
- të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, mbi 6 (gjashtë ) muaj burgim;
- të ketë integritet të lartë moral;
- të ketë së paku 3 (tre) vjet përvojë pune profesionale.

**Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:**

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Letra motivuese;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

### PROCEDURA E KONKURRIMIT

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 12.10.2020, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);

**Aplikacionet mund të merren në këto vende**:

*Forma e shtypur***:** në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
*Forma elektronike***:** faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: *038/ 211-648, 038/211-182* dhe *044/ 567-041.*

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.
Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.

## Republika e Kosovës

**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**

*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Skupština Republike Kosovo ponovno objavljuje:**

### K O N K U R S

**Za izbor predsedavajućeg Komisije za razmatranje pri Regulatornom autoritetu za usluge voda**

Prema Zakonu br. 05/L -042 o regulisanju usluga voda, Komisija za razmatranje se sastoji od predsedavajućeg, izabranog od strane Skupštine Republike Kosova, jednog člana imenovanog od strane Autoriteta i jednog člana imenovanog od strane pružioca usluga koji je podneo zahtev za razmatranje.

**Mandat predsedavajućeg Komisije za razmatranje:**
Predsedavajući Komisije za razmatranje bira se na mandat od tri (3) godine, uz mogućnost ponovnog izbora za još jedan mandat.

**Kandidat za predsedavajućeg Komisije za razmatranje treba da ispunjava sledeće uslove:**

- da je državljanin Republike Kosova;
- da ima najmanje univerzitetsku diplomu četvorogodišnjih (4) studija ili završen master;
- da nije bio osuđen za krivično delo, preko šest (6) meseci zatvora;
- da ima visoki moralni integritet;
- da ima najmanje tri (3) godine radnog iskustva u struci.

**Aplikaciji treba priložiti sledeća dokumenta:**

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Motivaciono pismo;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz o državljanstvu Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu ;
- Dokaz da nije osuđen za krivično delo.

### PROCEDURA KONKURISANJA

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 12.10.2020. godine u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza" bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

**Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:**
*Štampana forma:* u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul."Majka Tereza" bb. ili u
*Elektronskom obliku:* internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana *u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/ 211-648, 038/211-182 i 044/ 567-041.*

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.
Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

| Pranuar më: / Primljeno: 25.09.2020 | | |
|---|---|---|
| Njësia / Jedinica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 4-610 - 46530 | | |

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Vëllezërit Frashëri"
Komuna: Lipjan
Data: 28.09.2020

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/025-CS/1.1 | Trajnim 1, Zhvillim profesional: **Gjithëpërfshirja dhe PIA** – Trajnim me prezencë fizike |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Vëllezërit Frashëri" ,Lipjan.** Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimi Gjithëpërfshirja do të vijohet nga pjesëmarrësit-mësimdhënësit me prezencë fizike.

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e Gjithëpërfshirjes;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Vëllezërit Frashëri" Lipjan, më së largu deri më daten; 06.10.2020** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Avdi Azemi**
**Telefoni: 049/ 852 - 692**
**E-maili: avdiazemi@gmail.com**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN
4 Nr.Br. 610 - 46520
Data/Datum 25.09.2020

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Ismail Luma"
Komuna: Lipjan
Data: 28.09.2020

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/024-CS/1.1 | Zhvillim profesional, trajnim 1: **Gjithëpërfshirja dhe PIA** – Trajnim me prezencë fizike |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Ismail Luma" ,Lipjan.** Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimi Gjithëpërfshirja do të vijohet nga pjesëmarrësit-mësimdhënësit me prezencë fizike.

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e Gjithëpërfshirjes;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Ismail Luma" Lipjan, më së largu deri më daten; 06.10.2020** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Driton Sadiku**
**Telefoni: 044/ 741 - 608**
**E-maili: dritoni.sadiku@hotmail.com**

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPSTINA LIPLJAN

| Pranuar më: / Primljeno: 25.09.2020 | | |
|---|---|---|
| Njësia / Jedinica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 4-610 - 46527 | | |

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Emin Duraku"
Komuna: Lipjan
Data: 28.09.2020

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/023-CS/1.1 | Zhvillim profesional trajnimi 1: **Mësimdhënia me teknologji informative** – Trajnim me prezencë fizike |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu "Emin Duraku", Banullë - Lipjan.** Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme:

- Trajnimi: **Mësimdhënia me teknologji informative** do të vijohet nga pjesëmarrësit-mësimdhënësit me prezencë fizike.

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.
Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e teknologjisë informative;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e teknologjisë informative (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu "Emin Duraku",Banullë - Lipjan, më së largu deri më daten; 06.10.2020** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Hazbi Sahiti**
**Telefoni: 044/183 - 336**
**E-maili: hazbi.sahiti@hotmail.com**

Gjej PUNË
• Lajme nga tregu i punes
• Shërbime shkrimi
Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:
- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

6 Vite Paty



# Fatime Pelaj- Mavraj

(15.05. 1936-28.09.2014)

Dashuria, dhimbja dhe malli për ty mbesin gjithmonë të freskëta Nëna jonë e dashur,
Çdo copë kujtimi e ruajmë më nostalgji.
Bujaria e një gruaje siç ishe ti dhe humaniteti yt na bëjnë shumë me fat se të patëm Nëna jonë.
Gjithëjetën do mbetësh piktura më e bukur,
për sytë tanë, gdhendur me shumë dashuri..
T'i pusho e qetë
Ashtu si shpirti yt...!

**Me mall te kujtojnë: djemtë Avdullahu, Rizaja, Avniu. Vajzat: Rabija Nazlija dhe Shukrija, si dhe nipat, mbesat, sternipat e stermbesat dhe i gjithë farefisi Mavraj nga Saradrani-Istog.**


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
RC cola
0.5L